

ALBANIAN POST

Nr.
38

Editor in Chief: Dr. Fatmir Terziu - Telephone: 07984497444 - contact@fjalaelire.com - www.fjalaelire.com



22 Zëri...



19 Demokracia...



10 Rikthim...

TETOR /
OCTOBER
2021

NGËRÇ

Në përfjetje në dhomën e zbrazur zbresin të gjithë kufinjat. Mendimet, memorjet, kujtimet, trazimet, shqetësimet, këndvështrimet, hallakatjet, lodhjet, dertet, gëzimet dhe hidhërimet, qindra të ngjashme si këto me apoteoza kundërshtish hyjnë e dalin duke ricikluar një ekzistencë si në një album me fotografi. Fotot, të gjitha të përshtatura me hijet, merimangat me stilin e kornizave nga zdrukthëtar i mendjes pikturohen si në filxhanët me një kafe të fortë, një plazmë kafeje, që kundërshton me shkumë kremin e kaftë në syrin e dritës. Dhe kërsheia bën...



(vijon në faqen 02)

24/7 orë linjë emergjence
07878335000



RASHID & RASHID
Solicitors, Advocates
Immigration Specialists
Commissioners of Oaths



Këshilla
ligjore
FALAS

Specialist i azilit të
trafikimit njerëzor

RASHID & RASHID LAW FIRM
190 Merton high street,
Wimbledon, London, SW19 1AX
solicitors@rashidandrashid.co.uk
Tel: 02085401666

(vijon nga faqja 01)

hijen e panjohur për ndjesinë, zbrazëtinë, për pjesën tjetër të dhomës.

Zbrazëtitë percepton jastëkët. Ata në qasjen e parë janë të bardhë. Në të dytën të pamjaftueshëm, të shurdhër. Në të tretën e paqartë, ku mbesin sinjale të fryra në kornizën e shtratit të paqtë.

Kaq, mjafton vetëm kaq!

Mjafton të shohësh si zbresin e shënjohen pa zë kufinj të jetës normale. Mjafton të ndjesh se si, madje pa skajet e veshjes, që duken më shumë një larushi, zdrugohen zbrazëtitë fatale në ambushti, e të gjitha janë aty, janë me ty dhe pa ty, trupzbrazur tej pamjes reale.

E ti e ndjen një shkundje. Është sikurse një fëmijë është qortuar në përgjumje. Dikush të duket se të mban ende për dore, në mënyrën prindërore, mes ekzistencës dhe zbrazëtisë ndjesore. Dhe ti shkon e shkon, askund përtej, aspak më tutje, mbetesh i heshtur në pritje dhe në lutje. Të gjithë janë me ty dhe s'janë aty. Janë si shpalosje të një libri të pashkruar që të duket se shpaloset fletë pas flete. Të gjithë janë kufinj në vetvete. Askush nuk shkon aspak më tutje, dhe askush nuk e kupton se të gjitha janë vetëm kufinj në zhdukje.

Ngërç. Diku shoh një të njohur, diku e ngatërroj me një të huaj. Nuk di mendimet ku t'i bluaj. Nuk di çfarë të shkruaj. Në këto kufinj që treten në vetvete, e gjitha mbetet një plagë që fashohet nga e humbura. Më duket

sikur edhe Pena ime nuk do të gjejë fjalët e duhura. Kufinj në vetvete, kufinj që vetëvetiu treten. Kufinj të trazuar, kufinj të harruar. Mbërthyer në një vend të ndaluar.

Ngërç. Pse jemi të hutuar? Ku jemi, ku kemi gabuar?!

Duket sikur ne dhe brenda nesh gjithnjë janë dy njerëz. Dy sepse gjithnjë kemi jetuar jo për veten, por për Tjetrin. E kemi ndërtuar kufirin dhe i kemi vënë tokës, shtëpisë, gjendjes dhe ekzistencës metrin. Metrin me Njeriun e mirë, metrin me komshiun, metrin me vëllanë, metrin me dynjanë. Dhe kështu me këtë metër hymë pa e kuptuar dhe në sistemin pluralist, mbi një deklaratë të ngërçit të universit dualist. Dhe tashmë themi nën zë: „që ai ka krijuar“, „që ata kanë krijuar“. Po ne? Ne kurë nuk menduar si duhet dhe ku duhet jetuar?! Unë mendoj se çdo univers dualist përfundon në formën më absurde, shkurt kot së koti, është kjo që besohet vetëm në një lloj Zoti. Një Zot i fatit të Njeriut. Një Zot i drejtë, i mirë, vetëm i Jetës së Lirë.



185 Station Road, Edgware, HA8 7JX

0209306873

MIRËSEVINI

CRYSTAL
CAFE

MUZIË LIVE E PREMTE DHE SHTUNË



Ne Ofrojmë:

Ushqime tradicionale, Evenimente festive, ditëlindje, mbrëmje, dasma etj. (50-60 vetë)
Pije të ndryshme shqiptare:
Verë të kuqe dhe të bardhë
Raki Rushi Skrapari



way2save



**SPECIAL
OFFERS**

Çmime konkurruese




Kualitet

Cilësi



Shërbim i Kulturuar

**Respekti për konsumatorin
dhe klientin!**



Telefoni: 020 896 13057

Emaili: info@way2save.co.uk



Addressa:
37-41 High St.
Harlesden, London
NW10 4NE

PËR KUVENDIN E PARË TË STUDIMEVE ARBËRESHE

Nga Gjokë Dabaj

Ky Kuvend i parë i studimeve arbëreshe po mbahet në Tiranë. Dita e parë më 27 shtator, dita e dytë më 28 dhe dita e tretë më 29 shtator.

Shkova atje me dëshirën për të dëgjuar, edhe më mirë se deri tash, historinë e asaj pjese të kombit tonë dhe sidomos për të marrë vesh si do të veprohet në të ardhshmen nën shembullin e një të atillë shpirti të kombit tonë shekull pas shekulli të shenjtëruar.

Jam kryetari i një institucioni në krijim e sipër, me emrin tejet domethënës "Përkujdesja Gjithshqiptare" dhe prandaj më thërriste në atë kuvend jo vetëm dëshira, por edhe detyra.

Shkova, por nuk munda të qëndroja! U largova prej andej që ditën e parë!

Nuk pata shkuar për t'u larguar! Pata shkuar për të ndenjur aty dhe për t'i ndjekur të gjithë punimet, në të gjitha ditët që ishin shënuar në program. Sepse po flitej për arbëreshët! Sepse po flitej për atë pjesë të kombit tonë, që duhet marrë imituar për mënyrën si e ruajti gjuhën tonë për më shumë se gjashtë shekuj, atje, jashtë atdheut dhe në pamundësi për t'u lidhur organikisht me atdheun për shumë kohë.

Sepse jashtë atdheut i kemi sot disa milionë shqiptarë! Në Turqi një gjashtë apo shtatë milionë, në Greqi më shumë se dy milionë, disa milionë nëpër Evropë e nëpër Amerikë.

Dhe sepse duhet bërë diçka që kaq milionë, t'i kenë si shembull pikërisht arbëreshët, mërguar para gjashtë shekujsh në Italinë Jugore dhe megjithatë, ruajtur edhe gjuhën, edhe traditën tonë!

Tek po lexonin punimet e vet studiuesit, që ishin ngarkuar për të mbajtur kumtesa, po përgatitesha për ta thënë fjalën time edhe unë. Jo si

referues, por si pjesëmarrës në diskutime. Po mundohesha të bëja një konspekt të fjalës sime, të atillë që, sado kudo, të plotësohej materiali që kolegët e tjerë po e lexonin.

E dija që organizuesit do të ma jepnin fjalën. E dija që duhej të dëgjohej edhe fjala ime, siç duhej të dëgjohej edhe fjala e ligjëruesvet të tjerë.

Por i hodha sytë disa herë, madje shumë herë, nëpër sallë. Sa njerëz kish aty, që do ta dëgjonin atë që unë e quaja të domosdoshme për t'u thënë?!

Nuk ia vlente! Sinqerisht nuk ia vlente dhe unë e di ç'po mendonin në ata çaste vetë ata që komisioni i kish caktuar për të referuar. Kishin ardhur ligjëruesit që nga Italia! Kishin ardhur nga Prishtina! Të gjithë ishin të zhgënjyer! Nuk mund të mos ishin të zhgënjyer!

Në njoftimin e parë të komisionit organizues që thënë që këtë Kuvend do ta përshëndeste vetë Kryeministri i Republikës së Shqipërisë. Por doli që aty nuk erdhi as edhe një ministër dhe qeveria e Tirannës u përfaqësua në nivel aq të ulët, sa përfaqësuesi i saj nuk i katranosi dot as tri fjalë ashtu si duhej.

Në atë Kuvend atë ditë duhej të ishin e pakta njëmijë vetë. Duhej të gëlonin me qindra adhuruesit e veprës së arbëreshëve! Brenda dhe jashtë atyre ambienteve! Vetëm ashtu do t'u dëshmohej profesorëvet të ardhur nga Italia, se "gjaku i arbrit" nuk është shprishur!

A mos i pengoi kovid, po thua?! Jo! Dasmat i kemi plot me dasmorë! Stadiumet plot! Lokalet plot!

Aty duhej të ishin sot 700 apo 800 djem e vajza, nga ata e ato që u vlon shpirti për kombin dhe që ndiejnë respekt e dashuri ndaj atyre

arbëreshëve që e ruajtën gjuhën tonë për gjashtë shekuj, pa qenë brenda atdheut!

Në mitingjet e partivet gjenden të rinj e të reja për të zbuluar tribunat e politikanëve. Kur bën miting Ed Rama, ka me dhjetëra rinj që i rrinë në sfond dhe rrotull tij. Kur bën miting Lul Basha, ka me dhjetëra të tjerë të rinj që i rrinë afër.

Pra, rini që kundërshtojnë një-tjetrin, që përgatiten t'i hanë kokën një-tjetrit, kemi plot! Ndërsa rini që e adhurojnë qëndresën shtatëshekullore të një pjese të kombit tonë, nuk paskemi!

Shkaqet janë shumë të thellë. Ne nuk mund të jemi indiferentë ndaj të këtilla dukurive! Ne nuk na lejohet të jemi indiferentë!

Sa të rinj shqiptarë studiojnë albanologjinë në universitetet tanë private?! Madje, nuk e di a ka apo s'ka fakultet të gjuhës shqipe dhe të letërsisë shqiptare në ndonjërin prej universiteteve shqiptarë private. Po në Angli, universitetet private a kanë fakultete të gjuhës dhe kulturës angleze?!

Sa prej të pasurve shqiptarë i çojnë sot bijtë e bijat e veta për të studiuar gjuhën shqipe?! Sa prej pushtetarëve tanë, që nga kryeministrat e presidentët, deri te ministrat ose edhe kryetarët (kryetarucët) e bashkivet dhe komunavet, i kanë çuar fëmijët e vet për të studiuar gjuhën shqipe dhe për t'u kushtuar në atë mënyrë

mbarrëvajtjes së kombit tonë?! Sa prej deputetëve tanë, në Republikën e Shqipërisë, në Republikën e Kosovës, në Republikën e Maqedonisë Veriore, i kanë çuar fëmijët e vet për t'u kushtuar gjuhës shqipe, letërsisë dhe kulturës sonë kombëtare?!

Sigurisht, unë nuk them që, tani, të shkojnë të gjithë për t'u kushtuar gjuhës dhe kulturës kombëtare, duke lënë pas dore ekonominë, inxhinirinë, mjekësinë, drejtësinë, shkencat e natyrës dhe shkencat e indistisë. Por gjithsesi duhet edhe klasa e pasur dhe ajo shtetdrejtuese ta kenë njërin sy edhe në kahun e ruajtjes së gjuhës dhe të kombit që i përkasin.

* * *

Mbeti salla me më pak se 4-5 vetë! Më shumë kish ligjërues se dëgjues! U largova! Ika, duke vrarë mendjen: Ç'do të mund të bëja tjetër, veçse të shkruaja diçka?! Diçka si kjo që do të lexoni më poshtë.

Cili është faktori vendimtar, që arbëreshët e Italisë Jugore i ruajtën gjuhën dhe traditat arbërore?!

Faktori vendimtar, që arbëreshët e vendosur në Italinë Jugore, i ruajtën gjuhën dhe traditat arbërore ka qenë praktikimi i ritit të krishterë lindor në kishat e tyre! Mesha në ato kisha, në kishat e ritit lindor, celebruhej në arbërisht dhe bënte që në ato kisha të mos shkonin vendësit italianë, që ishin të ritit perendimor...





RASHID & RASHID

Solicitors, Advocates
Immigration Specialists
Commissioners of Oaths



Këshilla ligjore FALAS

Specialist i azilit të
trafikimit njerëzor

- Dokumente udhëtimi
- Procedura për leje qëndrimi dhe viza
- Kur jeni kotigjent për t'u riatdhesuar ose të ndaluar nga organet e emigracionit
- Mbulojmë të gjitha aspektet e emigracionit
- Zgjatje vizash
- Leje pune
- Rishikim juridik
- Apelimi Tribunali
- Rastet e trashëgimisë

24/7 orë linjë emergjence
07878335000

Rashid & Rashid Solicitors, si të gjithë avokatët e tjerë në praktikë në Angli dhe Uells, është Kompani e autorizuar dhe e rregulluar nga Autoriteti i Rregullimit të Aplikantëve.

Avokatët tanë të emigracionit kanë mbi dhjetë vjet përvojë në fushën e emigracionit dhe ligjit të azilit.

RASHID & RASHID LAW FIRM
190 Merton high street,
Wimbledon, London, SW19 1AX
solicitors@rashidandrashid.co.uk
Tel: 02085401666

E DUHUR PËR DËRGESAT TUAJA: EDUARD BALA

Mjaft kompani transporti e nisin me një slogan sikur janë qindra vjeçarë në këtë profesion të ri të tyre. Dhe më së shumti duan të theksojnë se kanë kryer dhe transporte të mëdha, kur dihet se si njëra dhe tjetra janë vetëm tentativa dhe lojëra fjalësh.

Kompania "Eduard Bala" mbetet më e saktë dhe me një eksperiencë të gjatë, natyrisht jo vetëm në Shqipëri dhe Angli dhe në destinacione të tjera ndërkombëtare në fushën e transportit ndërkombëtar të mallrave dhe mjeteve të ndryshme, ofron për të gjithë klientët e saj një shërbim të kompletuar dhe sigurt transporti.

Siguria, shpejtësia dhe garancia e punës së zhvilluar ndër vite ka bërë që sot shumë bashkëathetarë dhe miq, të

tjerë të lidhur me Atdheun tonë të dashur dhe mjaft anglezë madje që kanë shkuar të investonë në Shqipëri, po aq dhe imigrantët që jetojnë, punojnë dhe studiojnë, prej shumë vitesh në Britani të Madhe dhe në Europë kanë ardhur në pikën më të mirë të mirëkuptimit të na besojnë transportin e mallrave të tyre drejt Shqipërisë.

Duan të themi se kjo kompani e njohur tashmë nga eksperiencia e saj dhe nga aktiviteti serioz, po aq dhe nga respekti, nga përkushtimi dhe përgjegjësia e plotë gjatë gjithë procesit të grumbullimit të mallit deri në dorëzimin e tij në destinacionin final, mbetet konkurrese dhe në çmime. Ajo mund të kontaktohet në numrat e telefonit ose në WhatsApp, Viber, Facebook, Instagram dhe e-Mail për

tu informuar mbi datat dhe lokacionet e grumbullimit dhe shpërndarjes së mallit. Misioni i kësaj kompanie është të vazhdoj rrugën e suksesit në vijimin dhe përmbushjen e standarteve të një shërbimi transporti modern dhe efikas, me një garanci, mosprishje të mallrave, dhe me dërgimin pa probleme të tyre. Vizioni natyrisht mbetet qartë, të vazhdoj të mbetet një kompani lider i padiskutueshëm në transportin e Mallrave nga Britania e Madhe dhe vende të tjera të Europës drejt Shqipërisë dhe anasjelltas. Kjo kompani funksionon me furgonë të posaçëm për këtë punë dhe me dy drejtues makinash të sprovuar në mjaft vende të huaja. Nëse jeni duke kërkuar për një kompani cilësore, efektive, transparente,

kompetente, të besueshme dhe profesionistësh, atëherë "Eduard Bala" është zgjedhja e juaj e duhur dhe e domosdoshme në çdo kohë. Me Eduard Bala e gjitha që ju dërgoni dhe prisni të merrni në destinacionin tuaj është në dorë të sigurtë dhe me garanci të plotë.

Mbi 50 kg i marrim dhe i dërgojmë në destinacion. Respekt-Shpejtësi-Saktësi-Garanci-Kualitet

TRANSPORT MALLRASH:
ANGLI-SHQIPËRI &
SHQIPËRI-ANGLI
ANGLI:
+447 39 528 7400

SHQIPËRI:
+355 68 367 6959
+355 69 470 5893



TRANSPORT MALLRASH

Angli-Shqipëri-Angli



Eduard Bala

Për çdo dërgesë mbi 50kg i marrim dhe i dërgojmë në vend-ndodhje.



Mobile Angli:
0044 739528 7400

Çmime konkurruese!
Garanci.
Shpejtësi.
Siguri.



Mobile shqipëri:
00355 69 470 5893
00 355 68 367 6959



Email: eduardbala73@gmail.com

MESAZHI PAS NJË “ENIGME”

Cdo gjë kalon. Rrjedh. Ikën. Vjen dhe largohet. E panjohur? E njohur? E kuptueshme? E pakuptueshme? Çdo gjë përjeton ciklin e lindjes dhe vdekjes. Çdo gjë... atëherë ku është Shtegu? Këtë pyetje nuk e kam për veten. As për Ju. As ... për fëmijët tuaj. Këtë pyetje nuk e kam për të gjithë. Këtë pyetje nuk e kam as edhe vetëm pyetje. Edhe pse Ju do t'i vendosni me gramatikë, me rregulla drejtshkrimore pikëpyetje, unë ende mendojem se kë shenjë pikësimi do të duhet të vendosja në fund të kësaj enigme. Të kësaj enigme disi shqetësuese. E fundja nuk e kam për notën, që duhet të më vihet nga korrektorjësia, as nga ajo që do të zgjojë leximi i kësaj note shqetësuese. Fundja...

Ku është Shtegu? Një shteg që këndon me hijeshi me dihamën tënde, me aromën e trupit tënd të gjallë, me lëvizjen e flokut të mbetur në suprinën e kokës mbi ballë. Në lartësitë e Parajsës Më të Lartë? Kisha dëgjuar, prej teje i shtrenjti Baba, se si e quajnë këtë vend. E di me emër, me vendndodhje, me shenjat e së shkruarës, me faktet e të shkruarës, me rrëfimet e së djeshmes, me udhëzimet e të ndjeshmes.

Nga Miti më i Lartë, drita e gjatë dhe retushimi i ndjeshëm i një dore të padukshme, mbi një mahijë të mbushur me aromë, nën një réfryrje të shkurtër syri udhëton i qetë për në qytetin antik të Jetës. Qyteti i Jetës është një qytet me antikitet të madh në Botën e Madhe dhe të Vogël, që i përket vetë Udhës, ku Njeriu lind, ngrihet, shtrihet dhe ... pyet për këtë emigrmë: Ku është Shtegu?

Ishte një shenjtë dhe një shenjtërore e padukshme në ditët e kësaj fryme

shqetësuese, që doli nga e padukshmja dhe që kërkoi në bekimin profetik të regjistruar në Librat e Shenjtë zgjidhjen e vërtetë. Kur fjalët u mundën nga Fjala, kur mbeti vetëm enigma, të gjitha kureshtjet përnjëmend, gjetën strehë në këtë vend. Sot, kjo strehë është e njohur për një hartë të madhe që rritet përditë dhe që ende nuk është votuar të hyjë në sinorin profetik të Tokave të Shenjta.

Kjo strehë nuk është as në ndonjë hartë.

Edhe pse strehëza të tilla janë harta më e vjetër e njohur e Tokave të Shenjta. Detajet janë befasuese dhe streha është e bukur. Në fakt, kjo strehë është aq e saktë sa të mëtejshmit, vazhduesit e Qytetit të Jetës e kanë përdorur atë për t'i ndihmuar të zbulojnë vendet e mëtejshme mistike, kur nuk ishin të sigurt për vendndodhjen e tyre në errësirën e ikjes. A nuk është e bukur?

Na duhej të prisnim jashtë Fjalëve të përcjelljes, derisa fjalët e shtruar ishin në udhën e tyre ... në udhët e tyre. Ndërsa prisnim dihatjet, udhëzuesi ynë, Fati i Njeriut, shpjegonte në heshtje atë që do të shihnim dhe na dihaste nga padukshmëria, se çfarë

të kërkojmë një herë brenda enigmës. Isha duke qëndruar në këmbë (duke u përpjekur të isha në pikën e duhur) mu nën një pemë ulliri. Ndërsa ndiqja me sy dhe ripërsërisja “Ku është Shtegu?”, më dukej sikur kurrë më parë nuk kam qenë kaq afër një dege ulliri!

Ku është Shtegu? Qielli i shtatë, i shtatë qiejve.

Ku fjalët, përshtirjet, dhimbjet dhe lamtumirjet ... dhe të gjithë Fëmijët e Shpirtit, vallëzojnë.

Rreth e rrotull në livadh, aty ku rriten lulet, ku i Përrjetshmi sheh dhe vegjeton se si lulëzon Pema e Jetës.

Ku është Shtegu? Qëndro i qetë, pëshpërit kumuria, qëndro i qetë reagon pëllumbi. Ju keni një çelës! Është fryma. Ajo më pëshpërit. “Ndiqni frymën tuaj”. Për ku pyes veten, për ku? A duhet të marr frymë? Synimi i mendjes sime, qëllimi i zemrës sime, i lidhur nga një unazë e artë, rrymat e frymëmarrjes, në frymëra rrethohen. Kjo nuk është më enigma!

A e keni ndjerë atë? Ai moment qetësie. Pas hyrjes dhe para daljes ..., drejt hyrjes dhe ndaljes. Unë heshta dhe tunda kokën. Ku është Shtegu?

I shtrenjtiim, Baba, buzëqeshja

filloi të mbulojë horizontin. Duke shtruar e shkundur me shkëlqim grimin e Ditës, ndjeja arsyen e kësaj enigme.

Gautama Buda, i njohur gjerësisht si Buda, që ishte një Sramaṇa e që jetonte në Indinë e lashtë, në kësi rastesh është shprehur: “Kjo ekzistencë e jona është kalimtare si retë e vjeshtës Të shikosh lindjen dhe vdekjen e qenieve është si të shikosh lëvizjet e një vallëzimi. Një jetë është si një rrufe në qiell, që nxiton, si një përrua poshtë një mali të pjerrët.”

Ndaj dhe mesazhi pas një enigme është vetë përgjigja e çdo dite. Përgjigja, pra është mesazhi i çdo dite. Nuk është thjesht një përgjigje ... Është Dashuria që duhet të rritet! “Po!!” “Po!!” “Po!!” Ky është shtegu që nuk duhet të venitet. Ky është shtegu. Historia e jetës së fundit. Më pëlqen kjo frazë. Ka më shumë kuptim se sa historia e jetës, sepse ne marrim kaq shumë jetë midis lindjes dhe vdekjes. Një jetë për të qenë fëmijë. Një jetë që vjen në moshë. Një jetë për të bredhur, për t'u vendosur, për t'u dashuruar, për prindërit, për të testuar premtimin tonë, për të realizuar vdekshmërinë tonë. Dhe në disa raste me fat tipik njerëzimi, për të bërë diçka pas atij realizimi.



SKELA "JET SCAFFOLDING" CILËSI, PROFESIONALIZËM, GARANCI

Skela "Jet Scaffolding" tregon gjithnjë e më shumë përkujdesje në të tre elementët e saj të suksesit. Themelet e mira janë thelbësore. Shpesh kornizat e skelave kërkojnë më shumë pllaka bazë të thjeshta për të kryer dhe përhapur në mënyrë të sigurt ngarkesën. Skela "Jet Scaffolding" përdor pllaka bazë në sipërfaqe të betonit. Për sipërfaqet si trotualet ose pllakat bazë të asfaltit janë të nevojshme. Për sipërfaqet më të buta ose më të dyshimta përdor tabela të vetme, nën një standard të vetëm, një tabelë e vetme duhet të jetë së paku 1.000 centimetra katrorë (160 in²) pa një dimension më të vogël se 220 milimetra, trashësia duhet të jetë së paku 35 milimetra (1.4 in). Për skelat e ngarkesës më të rënda mund të kërkohej shumë më tepër elementë të betonit të vendosura në beton. Në hapat e pabarabartë të terrenit që priten për pllakat bazë, rekomandohet një madhësi minimale e hapit prej rreth 450 milimetra (18 in). Një platformë pune kërkon që elementë të tjerë të jenë të sigurt. Ata duhet të jenë të ngushtë, të kenë binarët me mburojë

të dyfishtë dhe të gishtin dhe të ndalojnë dërrasat. Duhet gjithashtu të sigurohet qasje e sigurt dhe e sigurt.

Komponentët themelorë të skela "Jet Scaffolding" janë tubat, bashkuesit dhe dërrasat. Tuba zakonisht bëhen prej çeliku ose alumini; megjithëse ka skela të përbërë që përdor tuba të fibrave të qelqit të mbështjella me filamente në një matricë najloni ose poliestër, për shkak të kostos së lartë të tubit të përbërë, zakonisht përdoret vetëm kur ekziston rreziku nga kabllo të elektrike që nuk mund të izolojnë. Nëse janë çeliku, ato janë ose "të zeza" ose galvanizuar. Tubat vijnë në një sërë gjërash dhe një diametër standard prej 48.3 mm. (1.5 tubacione NPS). Dallimi kryesor midis dy llojeve të tubave metalik është pesha më e ulët e tubave të aluminit (1.7 kg / m në krahasim me 4.4 kg / m). Megjithatë ato janë më fleksibile dhe kanë një rezistencë më të ulët ndaj stresit. Tuba zakonisht blihen në gjatësi 6.3 m dhe pastaj mund të priten në madhësi të caktuara tipike. Shumica e kompanive të

mëdha do t'i shesin tubat e tyre me emrin dhe adresën e tyre për të penguar vjedhjen. Bordet ofrojnë një sipërfaqe pune për përdoruesit e tribunave. Ata janë dru të kalitur dhe vijnë në tre trashësi (38 mm (e zakonshme), 50 mm dhe 63 mm) janë një gjerësi standarde (225 mm) dhe janë një gjatësi maksimale prej 3.9 m. Mbërritjet e tabelës mbrohen me pllaka metalike të quajtura pranga ose ndonjëherë pllaka gozhdë, të cilat shpesh e kanë vulosur emrin e kompanisë në to. Dyllat e tribunave të drurit në Britani të Madhe duhet të jenë në përputhje me kërkesat e BS 2482. Po ashtu, përdoret edhe stolisje druri, çeliku ose alumini, si dhe pllaka të laminuara. Përveç tabelave për platformën e punës, ekzistojnë bordet e vetme të cilat vendosen nën skelë nëse sipërfaqja është e butë ose që dyshohet ndryshe, megjithëse mund të përdoren edhe bordet e zakonshme. Një tjetër zgjidhje, e quajtur skatepad, është bërë nga një bazë gome me një pllakë bazë të formuar brenda; këto janë të dëshirueshme për përdorim në tokë të pabarabartë pasi

ato përshtaten, ndërsa bordet e vetme mund të ndahen dhe duhet të zëvendësohen. Skela, e quajtur edhe skelet, është një strukturë e përkohshme e përdorur për të mbështetur ekuipazhin e punës dhe materialet për të ndihmuar në ndërtimin, mirëmbajtjen dhe riparimin e ndërtesave, urave dhe të gjitha strukturave të tjera të bëra nga njeriu. Skelat janë përdorur gjerësisht në vend për të pasur akses në lartësitë dhe zonat që përndryshe do të ishin të vështira për t'u arritur.



ORDER NOW
and get 4 to 6 weeks
Free Hire
Call: 019 2351 8933



JET
SCAFFOLDING
LTD

Jet Scaffolding
Unit 212 Flexspace
5 Elstree Way Borehamwood
London
WD6 1SF

Tel: 0192 351 8933
Mob: 077 3874 0018
E-mail: info@jetscaffolding.com

**"Skela Jet" është e bazuar
në Watford, Hertfordshire dhe mbulon
të gjitha zonat në Londër.**

GUR I VENDLINDJES: PROFIL BIO

Gëlqeror. Sedimentar me dhe pa emocione. I dashur dhe i dashuruar. I dhimbshur dhe dhimbanak. Gur! Gur që është edhe i ftohtë. Gur, që nuk shkujdeset për atë që i prishet, ose nëse i struket dhe i fshihet në një rrëke. Reziston edhe në formë të prerë, në copa të vogla, forcohet më shumë nga rënia e nxituar dhe e mprehtë e ujit kristal të rrjedhshëm. Ndonëse, nuk mund të shuaj emocione, ai mund të sjellë shpresë, lumturi, hare, trishtim, por edhe inat dhe zili, mëri dhe hasmëri, ose edhe mund të mjaftohet me një përmbushje të thjeshtë. Dhe ajo do të quhet Ikje. Ikje...

Ikje dhe mbijetesë Guri. Ikje mes dhimbjes, por ikje dhe mes thjeshtësisë së Drenicës, Livadhisë, Strugës, Kërçovës, Homezhit, Dibrës, Kalimashit, Butrintit, Beratit, Tomorit, Korabit, Dumresë, Myzeqesë, Bregut dhe Shtegut e kudo ku

Guri shkëlqen më shumë se floriri, kushton më shumë se diamanti.

Guri nuk njeh kufij. Guri emeton kufij. Guri është me mua, por Guri është edhe me ty. Guri është tek tek të gjithë. Guri lind si një fëmijë. Guri vdes kur digjet në turrë tamam si një Burrë. E ai shkon në Përjetësi, kur prodhon Bardhësi.

Guri në të vërtetë ka vlerë. Ai është i tillë përherë. Guri është jetë, edhe pse e dimë ndryshe në të vërtetë. Guri është shpresë, është mbijetesë.

Shikoni unazat e dasmës, gurët e tyre në krye për të zbukuruar madhështinë, siç është garancia për të qenë me njëri-tjetrin, përmes një fjale të dhënë, pranë një bekimi hyjnor, mbi një pedestal të trashë dhe të hollë. Disa diamante janë të përafërt. Por, ato s'janë më të fortë se gurët. Nëse kjo është e mjaftueshme, më e vështirë mbetet dhe pothuajse e pathyeshme, ndjesia dhe

shija e tyre e klasifikuar në linjë molekulare, përtej klithmës dhe britmës, pranë haresë dhe jetës, e metuar si jetë, e shënuar me shtojzovalle të bukurisë, patjetër deri në thithmën e fundit të ajrit, gur ajo ndizet dhe gatuhet me magjinë e strallit.

Dhe lind të ndërtohet. Lind të ndërtojë. Të mbështjellë ritmin e jetës nën një çati, lind të prodhojë jetën e bukur si me magji. Lind të dëgjoj klithmën dhe të qarën që nga lindja deri tek vdekja.

Kur puthja e vdekjes na bën të pushojmë, një gur varri është kujtimi i trishtuar, mizor i një jete të mëparshme, që lulëzon dhe lotëzon, para se të kthehet në tokë. Ndodh që njëherë të ketë gjetur origjinën, fillimin e saj. Tashmë kërkon të mbajë nën të një zemër që qahet nga një tjetër, një shpirt që s'bëzan. Ndaj mbetet të jetë i dëshpëruar, të ketë qëlluar në shenjë yllin tuaj, duke garuar

nëpër lavdinë e netëve të yllit për të kapur një moment të pasionit trend, për të përcëlluar vetë-djegjen, në një shpirt, në një zemër, në një jetë, në një vend.

Djegja brenda atmosferës së përfaqimit të ngrohtë, djeg vetë gurin, djeg më të dashurin. Djeg, atë më të tërhequr nga impakti gravitacional. Dhe ndjehet kur ndjen atë që mbetet kometa e vonuar, duke u kthyer çdo ditë pa u djegur (aq shpejt) sa një meteor. E këtu qëndron një gur mbi të gjitha gurët. E di gjininë e tij..., e di racën dhe inferioritetin e tij. Ai është Guri prodhimtar. Ai është më shumë se një margaritar. E aty përkulem, jetoj, ndjej dhe thuajse më ndjejnë dhe ndihem ... E dashur, njësoj si një Diell që flakëron, më bën të shkrihem. Aty, dhe vetëm Aty ... Jam një Gur i Vendlindjes: profil bio.

ERMAL KARAKUSHI



PËRSE DUHET TË NA ZGJIDHNI NE

- ✓ INSTALIM I PLOTË OSE I PJESSHËM
- ✓ ZËVENDËSIME TË SISTEMIT TË SIGURES AVET
- ✓ SHITESË PRIZASH/ ÇELESAT, NDRIÇIMI ETJ.
- ✓ DUSHE/ LIDHJE GATIMI
- ✓ SISTEMET E NGROHJES/ STORAGE
- ✓ SHËRBI ME PROFESIONALE ELEKTRIKE

ermal_niceic@hotmail.co.uk

Zyra: 020 8443 3833

Tel: 07568393784

TË GJITHA NGA
NDERRIMI I
LLAMPAVE. NDRIÇIMI
DERI TEK SKEMAT
PROFESIONALE DHE
INSTALIMI

INXHINIER ELEKTRIK

NUK MË NJEH KUSH NË TIRANËN “SHTATZËNË”... -RIKTHIM TEK KRYEQYTETI I DASHUR PAS NJË DEKADE-

Nga Shefqet Meko

Koha fluturoi dhe erdhi momenti t'i rikthehem vendlindjes sime me emrin e bukur Shqipëri. Asnjë nga miqtë e mi amerikanë nuk ka mundur të shqiptojë saktë këtë emër kur ua them në shqip. Unë thjesht kam qeshur se, me sa duket, edhe emri im ka të njëjtin fat: keqshqiptueshëm nga të huajt. Por kur u them miqve të mij se jam nga kombi që i dha botës Nënë Terezën, ata befasi qëndrojnë gati-tu... Është magjia e hyjnore, që rastësisht ndodhi të ishte shqiptare...

Gati një muaj më parë para nisjes, më mbytën ëndrrat “me Shqipëri”, ëndrra që ishin fashitur në vrullin e përditshëm të punës në Amerikë. Është e vërtetë se jeta në këtë kontinent gjigand është “kominoshe dhe gjumë”, siç thonë shumica shqiptare, por besomëni, ka edhe po aq mundësi qeji dhe argëtimi sa edhe në Shqipëri. Sepse këtu së pari punon për egon tënde, pastaj për atë se “ç’thotë komshiu...”

Jam nga ata ikanakë të shekullit të shkuar, që e dua vendlindjen... Është pjesë e jetës sime, edhe pse e shkuar. Verbërisht i dashuruar pas ëndrrave varfanjake, pas të shkuarës me “njëshin në krye”, pas të shkuarës ku “ç’thotë partia bën populli” dhe të gjithë në turmë brohorisim me xhepat bosh, por shpresëplot se do vinte një ditë... Ajo

kohë erdhi. Nuk ka më “Njëshi në krye”... Jemi të gjithë në krye dhe po aq të marrë sa e kërkon koha që me shumicë e jeton njerëzimi i këtij globi... Kam aq shumë ëndrra për të treguar, kam aq shumë mall për të rrëfyer, kam aq shumë brenga për të ndarë dhe fluturimi drejt Atdheut tim më duket si “fluturim drejt ferrit”... Me një ankth të çuditshëm pres avionet të ndërrohen dhe hesht. Kam një mall të madh, që më duket idjotësi në sytë e atyre që jetojnë në Tiranë. Por unë shpresoj të më kutpojnë. Ndërsa fluturoj andej nga lind dielli, kam një ndjesi se do humbas mes ujrave të Atlantikut. Më duket sikur do vdes pa arritur në Tiranë, pa shtrënguar duart me ata që kam mall dhe i dua, edhe pse ma kanë harruar ermin... Frikem. Më duket se do le vejushë timeshoqe në Amerikë, më tmerron fakti se ç’fat mund të ketë ajo dhe nuk e di pse nuk kam hiçall për veten time që mund të vdes pa arritur në Shqipëri...

Arrij në Tiranë në një mbrëmje të vonë. Dësh zoti nuk ra avioni në flakë si dikur Drago Siliqi. Pata fat të vij i gjallë në Shqipëri. Dritat llamburisnin kudo. Adriatiku dallgëzon njësoj, si dikur në “kohën e diktaturës”, ndërsa rrugët janë ndryshe... Lëvizin mijra maqina, mijra ëndrra dhe dëshira... Nga lartësia shoh rrugë të bukura dhe një llamburitje konstante... A thua jam diku në

nuk mund ta anashkalojë Atdhuen ku unë rastësisht linda dhe kurrë nuk e vura në pikpyetje...

Një miku im i vyet më pret në aeroportin “Nënë Tereza”. Duke u përqaftuar me të, sikur përqafoj gjithë Shqipërinë. Ndiej frymëmarrje shqiptare, miqësi që nuk e gjen kurrë në Amerikë. Vite më parë kur vija këtu Shqipëria buçiste “Nano ik”!.. Ato kohë do më priste gazetari dhe botuesi shpirtmadh Medi Koxhaj dhe unë, më një karton në dorë do dilja nga aeroporti më fjalët e shkruara “Medi, mos ik”... Tanimë, Medi Koxhaj ka ikur me të vërtetë atje ku është “shumica” njerëzore... Tani është një “klime tjetër”. Krejt çuditshëm opozita është bërë “përsesh”. Ca bërtasin egërsisht “Basha ik” e të tjerë mallëngjueshëm si dikur para “tribunave të 1 majit” kur çirreshim “Parti-Enver, jemi gati kurdoherë”, një shumicë sikur evokon të njëjtën dijetësi shqiptare që kam kujtuar se ishte “histori e shkuar”. Harrova se historia përsërit veten. Shqipëria nuk bën përjashtim... Unë hesht. Dua të shijoj Tiranën time në heshtje dhe melankoli dekadore Ajo më duket si një bunker hitlerian, ku betoni dhe hekurat sikur ia marrin frymën qytetit më të bukur të rinisë sonë, Tiranës. Ndiej me dhimbje rënkimin e qytetit të “bërxollave” dhe “krikove të birrës”... Ndiej në heshtje hapat e lehtë në bulevardin e madh që sikur janë koncentruar në sheshin “kurrizo” në mes të Tiranës, që e bëjnë “loken” tonë si shtatzënë... Si një llavë vullkanike ndërtime janë përhapur gjithandej. Pa formë, pa plan, pa ide, pa vision, pa shpresë... Beton dhe hekur kudo. Pluhur, zhurmë dhe klafene kudo. Njerëz që i bien tavolinës me grusht, si dikur “Opinga e Hrushovit” në OKB.. “Pse nuk mori afganë Austria, por vetëm ky “I gjati ynë”?... Ku po shkojmë?...” Nata përcjell



zëra revolte gjithëandej, ndërsa jo pak kontrollojnë koshet e plehrave... Kjo dodh edhe në Amerikë, të varfërit dhe të pushpresët janë pjesë e shoqërive. Ata kanë vendin e tyre dhe ne, me fat ndryshe, ofrojmë mëshirë dhe lutje për ta... Këtu nuk lutet kush, këtu prania e tyre sikur lumturon një shumicë tjetër fatkeqe...

Gjindem i humbur në Tiranë e ëndrrave të bukura. Më duket se vetëm mali i Dajtit “vështron” mbi mua me një mishërim të ftohtë e të hidhur. Tamam si “yjet” e Arçibald Korninit. Ndihej i lënduar nga brenda. S’mund të shpejgohej. Nuk di se ku të çojnë rrugët dhe unë mbetem i hutuar mes llafnjës dhe betoneve kryeneçe. Tirana ka dryshuar. Tirana është zhbërë. Ajo është marrë “peng” i parasë që nuk mund të numurohet, por thjesht konvertohet në beton, hekur dhe qiellgërruese të frikshme... Kërkoj të gjej diku sahatin e madh, këtë symbol të qytetërimit shqitar, por nuk mundem. Është propozur mes kullash dhe betone pa fund. Më dhemb kjo katraure mbi ëndrrat dhe kujtimet tona. Më bën të bërtas si i çmendur në mes të sheshit “Skënderbej” që më duket si “Tirana me barrë”... “Këtu ka ndodhur “përdhunimi” më monstruoze i shekullit” belbëzoj në përlojtje. Humb duke hedhur hapat sa në lindje aq në perëndim, sa në veri aq edhe në jug... Hedh hapat me frikë mbi “barkun” e një sheshi që e lashë të sheshtë dhe të vërtetë. Tani frikem kur çapitem se mbase ndjell “dështimin” e turpshëm...



VILA RONEL



Vila Ronel Bar
& Restaurant
46 Birchington Road
London
NW6 4LJ

020 7624 1385

www.vilaronelrestaurant.co.uk

Reservation@vilaronelrestaurant.co.uk



SIMBOLIKA E KOMPLEKSIT “BABA” NË POEZI

Në një botë të tillë të ngarkuar me stres dhe me detyrime familiare, natyrshëm emri më jetik dhe më domethënës ende mbetet babai. Edhe pse në “modë” letrare, kjo risi është vënë në disraport nga teknologjia. Por poezia, si fjala më magjike e artit të Fjalës, ka marë përsipër më shumë se çdo gjë tjetër në fushën krijuese të mbajë ende gjallë ‘rolin e babait’. Teknologjia dhe shkenca kanë krijuar mënyra dhe risqe tipike për të thënë se, „kemi arsye të tjera, ... le të themi është kohë ndryshe(!)“. Poezia, ndryshe nga teknologjia, ndalet tek „Babai“, e jep ende me forcë të natyrshme tradicionale, e qas si një figurë qendrore (centrike) në marrëdhëniet e familjes. Kjo risjell në vëmendje autoritetin, jo thjesht patriarkalitetin, por krijon arsyen e „baba-tezës“ (‘father-tezës’). Të krijosh dilemën e ‘father-tezës’, që teknologjia na e ka dhënë peshqesh në shekullin ku jetojmë, është ndryshe nga ajo që poezia e krijon rolin e kësaj teze me fuqinë e saj, duke interpretuar marrëdhëniet e rrëndësishme familjare, sidomos ato baba-bijë, baba-bir, apo edhe në një sens tjetër atëror. Këtë “peshqesh” modern, duke sjellë metodat riskuese për figurën, rolin dhe aktin e babait, apo figurën për babain dhe familjen, e përjashton disi poezia. Herët në poezi ka qenë marë si shembull krijimtaria e poetes së mirënjohur Sharon Olds. Ajo figurën e babait e cilëson në vargun e saj, jo thjesht si një lidhje jetike mes kontekstit baba-bijë. Ajo e cimeneton dhe e zgjeron kompleksin e kësaj figure në detaje tejet të guximshme. Dhe guximi vjen deri tek pragvdekja.

Shkon tek intimiteti fizik i babait të saj, që vjen e shkrihet para syve të saj si një trup i vdekur, ku edhe elementët mashkullorë gjejnë kënvështrim tjetër dhe fuqi poetike, edhe në atë çast kur trupi fizik i tij është i mbaruar, por që gjithnjë ka siglën e dhimbjes dhe dashurisë së babait edhe në sytë e bijës.

Kjo poete e njohur, ka shkruar poezi që gjatë leximit të tyre e bëjnë lexuesin të mendojë se poezitë janë „intime“ dhe është e vështirë të besohet, se ato janë thjesht poezi

‘eprovete’ tenton të luajë rolin e babait, apo ç’figurimin e tij mbetet thjesht një trazim.

Babai si arsye jetike në poezinë femërore

Në këtë trazim mendoro-teknologjik janë edhe dy pena që sjellin lajtmotivin me poezitë e tyre për të tërhequr vëmendjen ndaj figurës së babait. Babai në poezinë e tyre mbetet një arsye jetike e poezisë femërore, që vjen nga dhimbja dhe dashuria për të. Julia Gjika me poezinë, “I vetëm babai



të përfytyruara. Te poezia “Heqja e këmishës” shihet më mirë ky këndvështrim i saj. Në këtë poezi, figura e babait është një kompleks dual që lidh elementët e psikoanalizës së Frojdit, në lidhje me ëndërrën e bijës për të ngjarë me babain. Këmisha ngrihet si një element tipik në poezi dhe forcohet me shumë arsye të këtij integrali psikoanalitik. Kështu poezia është ajo që krijon trazim ndryshe në mendjen e lexuesit dhe e shtyn lidhjen që prodhon teknologji-shkenca me burimet e saj në jetën tonë. Këtu kur procesi

im”, kushtuar babait të saj kremton mendimin ndryshe me ‘teknologjinë’ dhe prurja e saj mbetet e mrekullueshme tek ndalesa ‘traditë’, ku “I vetëm babai im” është një poemth që zhvillon mendimin e saj në “I vetëm brenda katër mureve”. Një sfidim poetik që vjen i dhimbshëm, por i qetë. Një varg që depërton brenda mureve katërshe, ku babai qëndron me orë të tëra, ashtu i shtrirë në divan “për të na pikturuar” me spatullën e saj tipike një labirinth jete me emrin e sigluar: Baba deri përtej dhimbjes.

Ndërsa autorja Eliana Leshaj (Alien) promovon lirshëm një mesazh piktoresk në tërë ressemblancën ushqyese dhe poetike duke rifreskuar në një tablo jetike figurën e saj më të dashur që paraqitet si “Babai jetim në pleqëri”. Alien depërton në strukturën lineare të vargut dhe tregon poetikisht në itinerarin kohor, çdo ndodhi që peshohet tek ideja dhe tematika jetike e poezisë së saj për babain. Lineariteti kohor në vargun e Elianës është një sfidë nomenklature për riskuesit e poezisë tradicionale, të cilën ajo e ka paraqitur tashmë të arrirë në thelb dhe në detaj.

Të dyja sjedhin baballarët si arsye jetike, si fakte për një simbiozë metaforike të jetës, por të dyja kanë një emergjencë që në gjuhën e Roland Barthes, mbart ekliptiken e mitit të babait në edukatën dhe jetën tonë. Babai në poezitë e këtyre dy autoreve është një baba në kohë, në vend dhe në arsye, por ai është dy herë arsye për të kuptuar rolin e tij përpos mitit, përpos logjikës së analizës poetike. Ne kemi një shans të gjejmë këtë baba në arsyen e Gjikes dhe Alien, por kemi edhe një domosdoshmëri për të sfiduar tendencën për kompleksin shkencor dhe atë letrar „baba“.

Rievokimi i emocioneve dhe eksperiencave

Kompleksi i babait në poezi është arsyetim logjik. Është një sfidë reale, një sfidë jete e vënë ndjeshëm në varg, në poezi. “Brezat”, është simbolika që mpikset tek kompleksi baba. Këtu në fakt poema dhe poezia gatuajnë ... (vijon në faqen 13)

(vijon nga faqja 12)

simbolikë për baballarët, nënat, bijat, apo bijtë. Në vitin 1988 Melanie Hart dhe James Loader, sollën si me magji një argument tipik për britanikët në 366 faqet e librit të tyre, që më pas në analizën e Margot Waddell u gjet përshtatja, të cilën unë e shoh tek poezitë e dy krijueseve shqiptare. Në këtë pikëtakim poetik dhe analitik unë në fakt zbulova arsyen e ekzistencës së një ligjësie midis poezisë dhe psikoanalizës që më në fund duhet të gjendet si domosdoshmëri lidhëse. Gjetja e kësaj domosdoshmërie si pjesë e simbolikës dhe formës eluzive është një mundësi për të njohur në brendësi emocionin dhe statiken e psikologjisë, të cilën Shekspiri e përshkruan si një dhënie arsyetuese ‘në ajri’ pra një “habitat lokal dhe thjesht një emër emocional” (A Midsummer Night's Dream, V, i, 11. 16-17) që është një proces i ndarë midis poetëve dhe psikoanalistëve të ndryshëm, secili duke arritur atë që synon për kuptimin i cili bëhet evident dhe identifikues tek ata që janë “frymëzuar të punojnë dhe të jetë krijues në të vërtetën jetike” (Eordsöorth, “Preludi”, XIII, faqe 100). sidoqoftë rievokimi është proces. Në këtë proces poezia ka vetëm një qëllim, rimodelimin e konceptit baba në principialitetin e thelbit, jetës dhe të vërtetës, që sfidohet nga dashuria dhe dhimbja.

Poetët kërkojnë të rievokojnë intensitetin e ndjenjës për babain, të angazhohen me mendimin e jetës njerëzore, me vlerat materiale, të emocioneve dhe eksperiencave. Langer thotë “poezia është mjeti për zbulimin e vlerave dhe jetikes,

ku prindi, natyrshëm babai, apo nëna kanë simbolikën e jetës...” (Langer, 1978:23).

Kodi i gjuhës për shoqërinë

Të dy poetet përdorin gjuhën e fantazisë dhe ëndërrave për të krijuar dhe fiksuar esencën e dashurisë dhe marrëdhënieve prindërore në rastet konkrete për baballarët e tyre të dashur, që janë një simbolikë përgjithësuese. Vetëm si një treguese klasike poetet prodhojnë kodin e gjuhës për shoqërinë që të diskutojë pasionin dhe tabunë e konfliktit dhe jetikes në familje, botën sureale të poezisë që premtan një histori në vargje për të përshkruar ndjenjën që autoret apo lexuesi të ndjehen krenarë dhe të dhimbshur, apo edhe “poete-borxhlije” ndaj babait.

Gjika dhe Alien, nuk janë të vetmit shembuj të krijimtarisë poetike që përdorin këtë stil për të krijuar ‘kathartik’, poezi të fuqishme për baballarët e tyre të dashur. Poetët e tilla janë shumë, madje kanë racionalitetin e vet poetik në këtë pikë. Gjetja e imazheve për emocionalen që situata gjeneron, për të mos bërë vetëm thjesht të përshkruajnë faktet apo strukturimin e tyre, është një teknikë që e afron lexuesin ngushtë tek shikimi i gjërave të skenës jetiko-poetike nëpërmjet syve, nda dhe poetët janë vlera në këtë fragmentim.

Hapjet poetike, në të dy krijimet e autoreve poetë, na dimensionon thelbin logjik si lexues nëpërmjet vargut, na jep të qartë realitetin e hijeve, ku çdo gjë që ne zbulojmë duke lexuar ka një signifimikim personal, një histori personale apo ndjenjë për

baballarët. Specifikimi i kohës dhe ambientit, vendndodhjes së babait te poezia e Gjiksës, po ashtu edhe tek poezia e Alien thërret për një përqëndrim të vëmendjes tek vetvetja, si në ratet konkrete: “Brenda katër mureve babai,/ Qëndron me orë të tëra./I shtrirë në divan...”, tek poezia e Gjiksës dhe: “T’kam ardhur te shtrati, mbrëmë/Në orën 12:00/Unë dhe mosha jote e re/Të puthem, të puthem.../Ti flije/E kishe gjumin e trazuar/Si shpirtin/Cila ëndërr të mundon, i vogli im i rritur!”, tek poezia e Alien, ku rithirja krijon një mundësi rilidhjeje midis së njohurës dhe të panjohurës, apo edhe midis ‘së lënë apo së fiksuarës në memorje’ dhe “së mbarturës momentale” po aq edhe të një numeriku besueshmërisë ku dymbëdhjeta është një numër mjaft i fuqishëm.

Veprimi si veçori dalluese

Tek poezia e Gjiksës: “Prek gjethet e gjelbëra të mëllagave/I gëzohet lules që çel./Këput piperkat e kuqe djegëse/Në dimër do ti shijoj me fasulet.”, tregohet për ne një arsye më shumë për të dëgjuar treguesen përcaktore poetike ku kumtimi dhe kushtëzimi janë kapur urgjentisht, por ndoshta jo deri në pafundësi. Thumbi poetik pasqyron atë që bota e babait në të cilën ai jeton, është një imagjinatë e pikturuar nga realiteti, një sureale ku jeta jetohet sin ë premisa reale, ashtu e ndarë nga një membranë që cflitet midis misteriozes, ekzistenca e së cilës nga ana jonë me vështirësi kapet, pasi ajo është një praktikë personale që lexohet për shumicën sublime. Në këtë mënyrë ne kemi kapërcyer

mbi realen e së panjohurës, në anën tjetër të vetmisë sip rag-vdekje pleqërie për babanë e vëmuar.

Në poezinë e Alien vargu: “Në orën 12:03/Flinte mosha jote e ere/E malli im i vjetër.”, është si një kanvas i bardhë ku ëndërra moshore jeton nën ombredhën e Zotit në tërë dimensionalen e jetikes njerëzore që siglon nga bija për babanë, si një klauzolë brezash jete. Piketimi i kohës për arsyen e prezantimit të ndjesisë qeshje në fytyrën e babait është shumë domethënëse dhe është një anaforë e vdekjes, apo shqetësimit ku vargu pikëlidh momentin simbolik.

Përfundim

Në të dyja rastet poezitë ‘aktrojnë në distancë’ duke siguruar anonimitetin. Asnjëra nuk përjashton simbiozën e pamores për të marrë detyrimin e gjykimit për arsyen në gjendjen e babait. Këtu figuracioni merr në dorë mesazhin e mesazhierit, që i bën këto poezi të jenë të paraqitjes së domosdoshme, të arsyeshme e të motivuar në thelbin tradicional të qasjes tek figura dhe konfigurimi letrar i babait. Në fakt të dyja janë jashtë simbolikës së kompleksit dhe kontekstit baba, por kanë një arsye më të ngjizur për të parë lidhjen mitike dhe jetike me ktë figurë të vetë jetikes dhe jetës. Jo më kot Wade Boggs shprehet: “Çdokush mund të jetë baba, por duhet dikush i veçantë për të qenë baba, dhe kjo është arsyeja pse unë ju quaj baba, sepse ju jeni kaq i veçantë për mua.”

JETA DHE MISTERET E SAJ

(Përgatiti: Adriana Myrtaj)

Asnjë studim tjetër nuk është më i jashtëzakonshëm dhe me përfitim më të madh se sa subjekti për mendjen. Mendja ka preokupuar intelektet më të fuqishme të të gjitha moshave, nga ditët e Aristotelit e deri më sot. Sidoqoftë, gjatë dy mijë viteve të fundit, me përjashtim të njëqind viteve të fundit, nuk është bërë shumë përparim në këtë fushë të shkencës. Anatomistët dhe mjekët kanë studiuar trurin dhe kanë injoruar mendjen, ndërsa psikologët kanë studiuar mendjen dhe kanë injoruar trurin. Mendja njerëzore nuk mundet, në vetvete, të bëhet objekt hetimi; ka nevojë për praninë e një aparati organik.

Mendja dallon njeriun nga kafshët dhe njeriun nga njeriu. Ndërsa nuk ka shumë ndryshim midis një lope ose një mace nga një tjetër, ndryshimi midis një njeriu dhe

një tjetri është i madh. Tek njeriu shkalla e ndryshimit shtrihet nga niveli më i ulët i idiotësisë në nivelin më të lartë të gjeniut. Nga njëra anë kemi një Njuton i cili mund të zgjidhë problemet më absurde dhe nga ana tjetër një njeri që me zor bën përpara në jetën e zakonshme. Bota gjithmonë e ka njohur dhe i ka bërë nder madhështisë së intelektit. Njeriu matet me atë që është, dhe jo me atë që ka.

“Cili është ndryshimi midis trurit dhe mendjes?” Është e habitshme se sa njerëz besojnë se truri dhe mendja janë sinonime të njëra tjetrës dhe i përdorin termat në mënyrë të ndërsjellë. Ndërsa marrëdhënia midis trurit dhe mendjes është intime, nuk gjendet as edhe ngjashmëria më e vogël për sa i përket pamjes apo funksionit të tyre. Përbërja dhe aktivitetet e secilit ndryshojnë aq gjerësisht sa radioja nga valët eterike. Truri është një radio

njerëzore, një stacion ose mjet marrje. Mendja është analoge me atmosferën eterike që e rrethon atë.

Edhe një krahasim tjetër. Truri është organi i mendjes ashtu si syri është organi i shikimit, ose veshi i dëgjimit. Natyrisht, përsosmëria e të parit ose e dëgjimit do të jetë në varësi të përsosjes së organit të tij. E njëjta analogji vlen edhe për mendjen.

Mendimi nuk buron nga truri, as nuk krijohet nga truri. Është mendja që mban mend, jo qelizat e trurit. Është Uni që mendon. Mendja është substanca të cilën e përdor “Uni”, kurse mendimet janë mjetet. Mendimet transmetohen në tru nga mendja, dhe për këtë arsye ndodh që truri ndikon dhe përcakton llojin dhe cilësinë e mendimeve të marra.



Substanca është e pandryshueshme. Ne e dimë se kemi të njëjtin identitet që kishim si fëmijë dhe gjatë gjithë përjetësisë do të jemi të njëjtët.

Për më tepër, truri është fizik dhe i nënshtrohet evolucionit. Mendja është shpirtërore dhe e përsosur. Truri është personal dhe individual. Mendja është universale. Këto dallime janë të një rëndësie parësore për një kuptim të saktë të mendjes.



+



PROFESIONALIZËM • GARANCI • CILËSI



**ABONIME
INSTALIME
RIMBUSHJE**

PËR MË SHUMË KONTAKTO GËZIMIN: 078 157 359 45

MALLIMI PREJ SË TRISHTËS, TEK VARGJET E PAVDEKSHME TË FISHTËS.

Mos u malloni me një rrënjë Rrapi që s'lexon. Rrapi që është bërë gjithçka, që ëndërron, që shkruan ..., që fotografon, që pretendon, që adhuron, që mendon, që këshillon, që ... fundja lum si ne që jemi rritur nën Hijen dhe Rrënjët e (a)tij Rrapi madhështor(!) (Sa breza me fat që paskemi qenë!) dhe ende jemi, se tashmë dëgjojmë çfarë ndoh në formën më Globale, ndjejmë anën më të thukët materiale, sygjerbojmë dhimbjen natyrale, e më tej shkojmë ashtu sikurse shkohet me sytë e përbotur në një ambient të lodhur nga Njeriu që pret pensionin e Tjetrit që ka harruar tollonin, por që e ka zëvendësuar me racionin e ri, me papunësinë masive në vazhdimësi... E sytë dhe mendja na qëndrojnë si Komb në Kosovë, aty ku janë bërë stivë e spicë trupat provokuese deri në rikthimin e dhimbjes tjetër në Mitrovicë. E poshtë dhe lart ka hije, ka shenja të një Rrapi me dhe pa vetëdije. Ka dashuri Globale. Dhe aty shkruhet, pa shkronja, pa fjalë të urta, pa Gjyhen e Fishtës, vetëm me atë që quhet...

E gjitha thuhet, dhe ashtu sikurse shkruhet është dyll, pra mos u sikletosni, „Bini në dashuri me pemën që gjeni në një pyll“. E ku qëndron problemi këty?! Sigurohuni që të mos jetë nga fis Rrapi, rrënjët e tij, hijet e tij, sinorët e tij, damarët e tij... dallitë dhe dalldisjet e tij... Gjejeni atë në kulmin e furtunës dhe të shtrëngatës së një vjeshte që sapo ka nisur, më pas në prag-dimri dhe më tutje të një nate që lë pasoja. Sigurohuni që ajo të mos e përziejë vërdallisjen e saj me dhimbjet

dhe ulërrimat e tjera të qena e të paqena, që u dalin simotrave të tjera nga jashtë e nga brenda. Duajeni atë që është duke shkukur flokët e saj xhufka-xhufka në krah të rrjedhës dhe rrëkëllimës me mejdan gjysmë të zbrazët. Mos e quani vdiq, por ndërroi jetë dhe u bashkua me numrin e qëlluar arithmetikë, me shënimin e poshtër: „Mallkuar qofsh o Covid!“

Por ju kërkoni ta gjeni. Kudo që ta gjeni, gjejeni atë që ka mbetur duke buzëqeshur me buzët e ngrira, sa nga etja e madhe, aq edhe nga pija. Sigurohuni që të zgjasë kjo ndodhi pak më shumë. Përdorni linja marrëse dhe dhënëse dixhitale, me praktikën nga kohërat moderne, nga më të fundit dhe argëtojeni atë me të shara parlamentare, qeveritare, rrugore, zyrtare, të kuptimita e të pakuptimita. Mos e zgjoni ndjesinë e saj të rraskapitur nga një ditë e gjatë dhe mos ia faturoni gabimet që dini se do të bëhen, vetëm në Tiranë. Merreni atë jashtë dhe dashurojeni në shi. Bëjeni kështu duke imagjinuar..., ose sepse e keni parë në një film. Komentoni për mirësinë e saj apo të tij. Për mirësinë e asaj peme që e keni dashuruar duke kërkuar veten tuaj të përhumur në një pyll, madje në një xhungël postmoderne. Mos e krahasoni me ndonjë pikturë alla-zyrtare, as me ndonjë ftesë për të qenë në ndonjë ekspozitë të tillë.

Gjithësesi edhe Ju tashmë jeni në atë Pyll. Jeni në atë xhungël. Jeni me hir, a me pahir. Ndaj, tërhiqeni atë në një marrëdhënie të tolerueshme. Lërinë muajt të kalojnë pa asnjë vërejtje. Pastaj le të kalojnë vitet pa u vënë re. Flisni, por jo për gjëra

të rëndësishme, por për asgjë, për asgjë me rëndësi dhe tërhiqeni bisedën nën të, kur ajri rritet i ndenjtur dhe mbrëmjet bëhen të gjata. Luftoni se si stërkalat e dushit (nëse e keni, apo ato kanaçet me vajguri në se i keni mbajtur) duhet të mbahen larg nga kaçurrelat e kësaj peme...

..., ajo tashmë është e mbyllur në pyllin e saj. Vetëm të Huajt duhet të flasin për fatin e saj, vetëm disa të ftuar, disa të angazhuar, dhe nëse ka mbetur ndonjë nga të paangazhuarit.

Propozoni pak më vonë, më vonë se sa të prononcohen të Huajt, sepse e kuptoni që do të kishit humbur kaq shumë, nëse do ta kishit bërë propozimin në ndonjë kohë ndryshe, thjesht para tyre. Merreni atë në një restorant, që shkatërron stomakun e pangrënë mirë me muaj me salcë dhe peshq të marinuar dhe kërko me dashuri nga kamerieri që të sjellë një shishe shampanjë të shtrenjtë...

Por, kujdes mos harroni bëni një fotografi se do të ju duhet. Mos harroni!

Ofroni një unazë modeste dhe mos u shqetësoni shumë nëse nuk ndjeni asgjë nga sinqeriteti, ose angazhimi i tërë kësaj strukture. Ju po jetoni të lumtur. Dhe aspak nuk duhet ta kuptoni se është fallco, krejt me dëshirën e të Huajve, ju po e dashuroni atë. Bëni këto gjëra. Sepse një jetë e jetuar në purgator është



më e mirë se ajo që jetohet në ferr. Ajo do ta bëjë atë më ferr. Unë po ju lus, qëndroni larg nga pema që rritet e tillë, nga pema që s'lexon, s'shkruan dhe flet si Njeri. Kush qesh, apo qan, kur ajo bën dashuri? Të huajt do të thonë JU? Kush mund ta delendisë me kujdes shpirtin e saj dhe ta rrotullojë atë duke e kthyer në prozë dhe poezi? Nëse ajo e do poezinë, ... ore, ikni. Mos guxoni ta shikoni nga pas, as një shikim nga mbrapa. Ajo do të mbetet e vetme. Buzëqeshjet e vogla janë të rrezikshme, dhe ato duhet t'ju bëjnë të tronditeni. Mos buzëqesh duke lënë sytë nga mbrapa.

Mos u dashuroni me një pemë që mendon. Do ta kuptoni se ajo është e përbërë nga magji dhe e njeh veten si magjistare. Mos e doni atë që di të zhduket brenda një libri, ose një poezie, apo qoftë larg brenda një pikturë. Nëse ajo harxhon më shumë se disa sekonda duke shikuar në sytë e një mëkatari, dilni prej aty. Më mirë të futeni në Bunk-Art, ose të imagjinoni se e keni kuptuar strukturën e diktuar nga Lart. Hë, ju lutem bëni kështu!

FANTAZMA!

(DISKURSI I SAJ ME FOTOGRAFI NË KRAH TË UDHËHEQËSIT)

Enjihja një familje me njëmbëdhjetë fëmijë. E dymbëdhjeta lindi në kohën e kafesë së elbit, por kurrë ajo kafe nuk u pi në atë familje, sikurse ndodhte me të tjerat. Atje pihej kafja nëntëqindëshe, dhe jo e jo ajo gjashtëqindësheja. Ama, të gjithë flisnin për një familje të urtë, të dëgjueshme, të respektueshme, edhe pse gjetkë, a diku vesh më vesh shpotazi fjalët kapnin rrëkerëza të tjera.

Punë thashëthemesh! – thoshin, e kanë inat se është nëna Heroinë, që ka takuar dhe bërë fotografi me Udhëheqësin.

Ndërsa ndodhte kështu, ama, të gjithë habiteshin me disa gjëra që ndodhnin ndryshe në atë familje: fikeshin dritat shpejt edhe pse kishin televizor me ngjyra, visheshin mjaft mirë, dhe pse askush prej tyre nuk punonte, por... ama kishin një fotografi të madhe, të vendosur në korridorin e shtëpisë, ku kishin pozuar në të Nëna Heroinë me Udhëheqësin e asaj periudhe. Shtylla e shtëpisë, i Zoti i asaj shtëpie e kishte merak literarshen e rakisë përditë dhe kështu bashkë me oreksin e saj ditë pas ditësh ai shtoi dhe oreksin e ditëve, orëve dhe minutave të ikjes nga ajo shtëpi e madhe, nga jeta e vet.

Kur e varrosën, të tjerët u mblodhën dhe diskutuan, pastaj me urdhërin e të deleguarve nga Lart mblodhën ndihma për përcjelljen e tij, por ndodhi që u habitën. ... dhe ishin të gabuar, kur të Deleguarit u

thanë që të mos bënin asnjë fjalë: “Një sy qorr e një vesh shurdhë”.

“Nuk mund ta baltosim, ta bëjmë hajdute, një familje të tillë me Nënë Heroinë në krah të Udhëheqësit” – u mësua vonë të ishte thënë.

Në atë familje nuk mungonte asgjë. Nuk mungonin as patatet, as fasulja, as... dhe të gjitha të vjedhura natën kur atje fikeshin dritat. Ndaj dhe gjatë varrimit, sikurse ndodhte në mjaft raste, folën Kryetari i Këshillit të

Pas disa vitesh të tjera në një nga Televizionet Publike, tre a katër fëmijë tashmë të rritur nga ajo familje, e quanin publikisht nënën e tyre “K...” dhe kërkonin që t’u bëhej ADN-ja se nuk e kishin pasur baba, atë që njihej në dokumentat zyrtare.

Dikush që e kishte parë këtë emision dje më tregoi një mesele tjetër... Pastaj diku në rrjetet sociale më bëri paralele me disa foto të tjera. U mundova t’i them se nuk kishin lidhje. Këto foto nuk janë ...

Por, ende pa e mbaruar unë fotografinë ai me plot nervozizëm më tha: “Janë e njëjta familje. Nëna e tyre ishte Heroinë... Kanë

foto përditë e më shumë po vjedhin nga ditët tona të jetës, dhe jo më fasulet dhe patatet e kooperativës.

Sot kjo fotografi ka lindur me gaz!

Si ditën kur u takuan për herë të parë. Por çfarë dobie ka një fotografi nëse vazhdon të dhemb? Frymë larg në rrjedhën e saj, larg në rrjedhën e ngjarjeve.

Përgjigjja është e paqartë. Gjithmonë e paqartë.

Por një gjë është e qartë, gjuha e këtyre fotografive: “Edhe nëse fundosem edhe më thellë në përfaqimin e dhimbjes, do të kujtoj ditën e ditëve më të mira”.



“Ore zotëri nuk dashke ta kuptosh? Kjo nuk është asgjë! Vjedhja është tashmë ilaç me fotografi... ndaj duhen këto fotografi në Facebook edhe me Udhëheqësin dhe me ...” Pastaj ka zëra se... se edhe Ai njeri është mbi të gjitha. Ka zëra...

Se çfarë?

Bashkuar, Sekretari i Byrosë së Partisë, e mjaft të tjerë dhe në ballë të varimit e deri në përcjelljen në banesën e fundit e shoqëronte kortezhin fotografia e Nënës Heroinë me Udhëheqësin.

Në atë kohë ndoshta kjo fotografi e kishte një arsye. Vonë, sapo kishte ardhur Pluralizmi, atë fotografi, sikurse u tha, vetë fëmijët e Nënës Heroinë, ia kishin lidhur një maceje dhe e shëtisnin nëpër udhë, duke tërbuar macen e gjorë.

privilegjin e saj dhe këto fotot me Udhëheqësa janë të ngjashme... Nëse nuk do ta kuptosh..., puna jote”.

Eh, mirë i thashë. Puna ime.

Pakuptimtë?

E Pakuptimtë?

Edhe nëse këto foto e bëjnë tani të pakuptimtën ende, vetëm sarkazmën dhe ironinë që nis në Tiranë e mbaron në Prishtinë nuk mund ta lënë në mëdyshje, ajo që mbetet për tu gëzuar është se këto

Zëra, more zëra..., që askush nuk përgjigjet.

Ato zëra...

Po zërat nga jashtë janë pozitive.

Po, kush do të përgjigjet për zërat nga brenda?

Fantazma! – i them. Të paktën fantazma e natës po na çon në gjumë. Të paktën ajo nuk ka pse të vdesë në një ëndërr. Ëndrra që u copëtua shumë kohë më parë...dhe na mbeti fantazma e fotografisë.

PLAKU I NEMERÇKËS

Burri me një veshje të përkujdesur ndali hapat e tij të lëshuar ashtu nxitimthi pikërisht aty ku vijëzat e bardha të gëlqeres ende ishin të pathara. Nga ai kënd Postenani i Leskovikut dukej si një skutë e marë nën sjetull nga majat përreth. Horizonti shkulte dhëmballat e akullta të dimrit të fundit, të cilat i ishin ngulur në trupin e tij, që nga ikja e shpejtë e Diellit andej matanë kreshtave të larta. Dhe pasi fshiu sytë mirë e mirë, ndoqi ngadalë e ngadalë ato vijëza të bardha derisa më në fund mbërriti pikërisht aty, ku burra e gra, fëmijë e pleq jepnin e mernin me furça të sajuara bimësh, që lyenin murret e asaj ndërtese disi të vjetëruar nga ikjet e hershme të të zotëve të shtëpisë. Dhe pastaj mori frymë thellë. E pa bardhësinë që kishin marë murret e asaj shtëpie dhe menjëherë fytyra e tij e qeshur shëtiti tërë hapësirën që merrte ngjyrimin e stinës që po vinte e përsheptuar, si kurë ndonjëherë. La çantën e tij të madhe dhe menjëherë u bë njësh me të tjerët...

Nga ajo kohë kanë fluturuar vite. Por, diku në një cep të Postenanit ende mbahen gjallë në memorje hapat e Thanas Sinës. Hapa që ia përjetoi shkumba e bardhë e gëlqeres së tejppjekur me të cilën ai gatoi shkronjëzat e ëmbla të shqipes. Dhe ajo shkumbëbardhësi gëlqerore që sillte në mjedisin e Leskovikut të vitit 1859 trokthëzat e vocërrakut që do të bënin më vonë mjedis dhe nder mes emrave krenarë si Pandeli Sotiri, Thoma Avrami e më tej me emra të tjerë të krenarisë kombëtare si Petro Nini Luarasi, Nuçi Naçi,

Janko Minxha, Kristaq Vaja etj, duket se janë ngjyer mes grisë së kohës që përditë e më shumë bën heshtasin.

Por, ende në kokën e Tjetrit, dëshmitarit, të dashuruarit të Gjuhës Shqipe heshtja nuk është zakoni i mirë. Dera e vjetër ende kërcet. Bën këtë grimë mesazhi zanor edhe kur hapet, edhe kur mbetet në mëshirën e memorjes. Në të njëjtën mënyrë që bënte gjithmonë. I njëjti tingull i vjetër mëshirues, i trishtuar, por nxitës dhe zgjimitar, që kishte bërë për vite me rradhë.

E trishtueshme sepse, si pjesa tjetër e memorjes, nuk do të heshte, ashtu siç ishte nëse dikush do të merrte kohë vetëm për ta rikujtuar atë, në këtë rast për të lubrifikuar ekzistencën, dhe atëherë ndoshta realiteti sikurse kyçi nuk do të ishte një zhytje e tillë me zhurmë në Histori.

Por kjo ishte ashtu siç ishte, dhe dera e vjetër përmbledh pothuajse të gjithë arsyet e heshtjes dhe zhurmës, para se të thuhet pak përtej heshtjes dhe zhurmës në brendësi të memorjes.

I lindur në mjedisin e fshatit të Jani Vretos, i arsimuar në bankat e asaj shkolle, ku më parë ishin ulur Kostandin Kristoforidhi, Naim Frashëri, Sami Frashëri e të tjerë, i brumosur që në moshë të re me idetë e rilindësve, 'Plaku i Nemerçkës' që kishte lënë pas mjedisin e anëtarëve të Shoqërisë së Stambollit dhe pjesëtarëve të familjes Qiriazzi, ardhja dhe heshtja e tij ishte pikërisht në atë mjedis tashmë një përshpirtje kohësh që e ngjizën atë dhe



e lidhën fort me dashurinë për ato vise të mjalhtëta.

E ndërsa diku heshtja zvarritet mes grisë së kohës, ajo që bëhet më e dhimbshme është vendi bosh në mjediset e Bibliotekës Kombëtare. Në këtë kënd të shpien kujtimet e një ish nxënësi të tij, Thanas Viso Mborja, që me kohë është shprehur qartë se Thanas Sina, i quajtur me pseudonimin 'Plaku i Nemerçkës', kishte përgatitur edhe disa tekste mësimore. Tekstet e tilla, nën emrin e tij, duket se janë thjesht një plangë tisesh të kohërave. Titujt e tyre 'Dituri e natyrës'; 'Fizika'; 'Zoologjia' edhe pse kanë këndin e tyre bosh, sidoqoftë edhe nëse kanë mbetur diku në dorëshkrim, për hir të vlerave dhe respektit ndaj një figure të tillë, duhet patjetër një përkujdesje. Aq më shumë kur fonde të shumta janë shkrirë e shkrihen për 'kërkime' personale të stafeve që ndërrojnë kostumet dhe shijet politike në mjedise të tilla, natyrshëm mungesa

e teksteve të këtij burri të shquar është akoma më shumë gri dhe grishëse.

Por një gjë është e qartë se ajo Derë, nuk mund të mbyllet në Histori, dhe se shkrimet e tij nën pseudonimin 'Plaku i Nemerçkës' mbetën një vlerë në faqet e gazetës 'Drita' të Sofjes, të cilën e hapi bashkë me Shahin Kolonjën, por edhe në faqet e gazetës 'Bashkimi i Kombit', të cilën e hapi bashkë me Muço Qullin në Manastir, apo edhe tek 'Kalendari' i Manastirit të botuar nga ish fshatari i tij Cile Vreto. Thanas Sina, i njohur edhe si Athanas Sina, ishte gazetar shqiptar, mësues dhe aktivist i Zgjidhjes Kombëtare Shqiptare. Sina ishte drejtori i dytë i Mësonjëtorjes, shkolla e parë e njohur zyrtarisht në gjuhën shqipe në Perandorinë Osmane. Ai ishte gjithashtu anëtar i organizatës Bashkimi, ku propozimi i tij i alfabetit në Kongresin e Manastirit do të bëhej alfabeti zyrtar i Shqipërisë.

MATRIARKAT

Edhe një herë. Këtë herë, ndoshta për të parën herë, pa ndrojtje, frikë, në të vetmen qasje aritmetikë. Aritmetikë në koren e athët, të gjithë vlerës së asaj që zbërthen krahët. Krahët që na bëjnë me dije, krahët që na bëjnë të fluturojmë, krahët që na bëjnë të kuptojmë. Dhe ne lexojmë udhën me dhe pa këto krahë, pa e kuptuar ndonjëherë se ku jemi, ku mësyjmë, ku mbetemi në fakt, ...në cilin kah. Shkurt, diku në të shkruar e lexuar, mësyjmë për të kërkuar si dikur „krahun“ e haruar. Krahun e „gurit të rëndë“ që të mban ende në kuriozitetin tënd. Dhe shkruhet pastaj ajo që e kemi lexuar duke ngrënë mjaltë e duke bërë baltë. Baltë. Baltë e papërpunuar nëpër rrëfenja, ninulla, këngë, poezi, shkrime, tregime, kallëzime e insistime narrative „frymëzuese“, madje edhe kryeneçe. Jo thjesht vetëm për letrat. As për veprat. Shkurt, si një pikëtakim në një agim. Më saktë, një qasje nga koha e harruar, ku peshon dhe pushton graviteti i një mjedisi të ndërlikuar. E në këtë mjedis jemi e vazhdojmë të mbetemi të gjithë Né, me moton e një lavdie të hershme, duke plotësuar nocionin e duhur Atdhé! Dhe lexojmë atë që shkroi hershëm, Demokriti: „Për një njeri të mençur dhe të mirë, e gjithë toka është Atdhéu i tij.“ Atdhé! E pastaj vjen kjo ditë, dhe pyesim në shkrimet tona, jo thjesht për ta ditë, ku mbetet të jetë Atdhéu i tillë?! Dhe zëri i përgjigjes vjen i ngatërruar. Vjen në veshin tënd, nga Aty ku ti kundërshton dhe është një ulërimë e zgjuar. Aty ku hyn e pathëna. Aty ku rend e rrënda. Aty ku hidhet lirshëm vallja dhe kënga. Aty ku e gjithë zhurma dhe

rrëmuja ndodh nga brënda. Aty ku ka një urim, një mallkim, një bekim... Edhe në fluturim. Aty ku të duket se ende nëna dhe babai duhet të të mbajnë për dore... Edhe në lartësi kohore, qiellore, kontradiktore. Dhe pastaj mendon të bashkohesh në truall tjetër, me „Njerëz të Mirë“. Zogj në fluturim të lirë. Zogj në një tufë pa kufinj, ... në një tufë pa arsytet, në humbje e sipër. E ti je Atje?! E ti ke Atdhé!? Kur një tufë humbet gjurmët e saj, ikën pas shpendëve të rastiit, hakërohen dhe fletët e shkruara e të pashkruara të fatit. E ti rend, rend, e rend..., fluturon si një shpend. Shpend, i bashkuan me shpendë. Shpendë të bashkuar nga thirrja, cicërrimat, hapja e krahëve, gjuha e mëvetësishme. Shpendë të riformtuar. Shpendë të deridikushëm të një udhe që të shpie në një botë. Shpendë në tufa. E udha të shpie e të shpie, të rikërkosh të tjera njohuri, të tjera dije. Të çon në një botë të lëkundjeve. Aty ku hijet lëvizin nën hënë. Atje ku nuk ka gjumë, atje ku gjuha është në symbyllje ... e sytë gati-gati tu ngjiten. Por, ti fle pa e kuptuar, fle në këmbë, pra gjumë kuajsh edhe ditën. Fryrjet e natës ndërthuren. Duke i mirëpritur ata në një përfaqim të ftohtë: Aty ku lind si një 'ëndërr' për të ngatërruar përjetësisht ëndërrat. Ëndërrat që herë ecin, herë ngecin, herë diktojnë e herë duket sikur marshojnë.



Në asnjë kohë nuk ndodh ndryshe, marshimi krijon edhe një ulërimë. Një të tillë zëzhurme të lemeritshme, që i bindet vallëzimit të fatkeqësisë. Por, refuzimi i saj fshihet nën një gjuhë. Fshihet atje, sepse atje është shenja e gurit, drurit, murit, çatisë, gruas dhe burrit, nipit e mbesës, tërë fëmijëve dhe fëmijërisë. Sepse është një strehë, e mbajtur nën siguri. Mbi të gjitha, është matriarkati, duke thërrmuar një këmbë të cepit të shkërmoqur nga erërat dhe furtunat, nga mizoritë dhe padrejtësitë. Era, si e vetmja, e sotmja dhe e djeshmja, bie në sfondin e heshtur ndriçues, ku vetëm toka e mbyllur në errësirë flet. Flet kur një fole refugjatësh zvarritet, duke u tërhequr lirisht nga lëvizja e kundërshtarit, në një moment të copëtimit. Kështu, është natyra nënë që qëndron mbi të gjitha, tek Ty o Njeri i asaj ane, i asaj balte, i asaj Toke, i asaj Bote. Sikur të fryjë një erë si ajo mbi lule dhe një herë, një frymë e gjallë, të ribëhet ..., qoftë dhe si në ndonjë baladë, qoftë si në ndonjë përrallë. Të paktën atje ku ishte Kisha dhe u shemb, atje ku ishin varret

dhe rrjedha u çmend, atje ku ishte Hoxha, Prifti, Sinagoga, Dervishi, e tërë ajo, pra Bota. Bota në veprën e saj madhore, Bota jote o Njeri. O Njeri që hyre në veprën e saj. Në veprën e saj, ajo qan në mënyrë të pandërprerë. Qan vajtueshëm, si në Vermosh, si në Ferrizaj, si në Gjilan, si në Kukës, si në Elbasan, si në Konispol, si në Vlorë, si në Sarandë. Qan me art, tamam, sikur një virtuoz të përplasit me vdekjen nga Lart. Dhe Arti i Fjalës së tillë, rishfaqet pas zhytjes së vdekshmërisë së ëmbël në argjilë. Pastaj shëtitet përreth, në mënyrë tërheqëse, tërësisht e ardhjes, mbetjes dhe tretjes, ... pastaj vetë shkon dhe vjen këtu si një e metë. Jo thjesht për Ty, jo thjesht për Ty o Njeri. Kur fle dita dhe nata, derisa të nudësh ritualët, ti je thjesht një absolut. Një absolut ... në këtë ritual të gjatë, me një lidhje të fortë matriarkat. Burri, i lindur nga gruaja, e ka pasur të vështirë ta falë atë që e lindi. Protesta patriarkale kundër matriarkut të lashtë ka dhënë fryte të çuditshme ndër vite. Dhe kjo ndoshta kërkon sqarim, pret kuptim. Pret jo vetëm nga Né, jo vetëm tek thelbi i ditëve të sotme Atdhé.

JA NJË PYETJE QË E GJEN PËRGJIGJEN TEK DEMOKRACIA

Nga Gazmend Cufaj
Kryetar i Grupseksionit të PD-
së Barking dhe Dagenham,
Britani e Madhe

Është një pyetje që ndodh dhe përsëritet gjithë këtë periudhë në Grupseksionin që drejtoj unë. Dhe ajo ka të bëjë me emra konkretë, je me Sali Berishën, apo me Lulzim Bashën. Të dy janë pjesa më adekuatë e PD-së, parti në të cilën unë militoj, jo thjesht si drejtues i një Grupseksioni, por dhe si një e tërë anëtarësie që nga koha kur lindi kjo parti në arenën demokratike shqiptare, dhe si një e tërë anëtarësie ku militon e gjithë familja ime, dhe fisi im në tërësi. Jam me PD-në, do të ishte përgjigjja ime konkrete. Por, jam dhe me Sali Berishën, jam dhe me Lulzim Bashën. Jam me Sali Berishën, sepse me këtë qasjen time

reale, konkrete, të sinqertë dhe demokratike, i shërbej Partisë Demokratike, u shërbej anëtarëve të devotshëm të Grupseksionit tim, miqve të mi, familjes sime, qytetarëve që njoh dhe më njohin si në Atdhe dhe në emigracion, dhe çdo demokraci. Unë jam në krah të Dr Berishës se demokracia është liri, dhe se sigureteti është kulturë demokratike dhe kulturë që na bën me detyrë dhe detyrim të gjithë demokratët. Unë dhe gjithë arsyeja ime, gjithë qenia ime si demokrat është e hapur për ti thënë doktor Berishës që je pjesë e historisë, por je dhe pjesë e përgjigjisë. Jam ashtu sikurse një mik i imi thotë prerë dhe hapur se që të kërkosh falje është cilësi. A mjafton përballë përgjigjisë??? Por një përgjigje e qartë është se unë jam natyrisht dhe me Kryetarin e PD-së, Lulzim Basha, sepse që të

dy dhe të gjithë e dimë se se Partia Demokratike është më shumë se një ulëse kryetari, sepse Partia Demokratike nuk është pronë, por është frymë. Jam i sinqertë me të gjitha angazhimet dhe direktivat demokratike të z Basha dhe natyrisht me to do guxoj të denoncoj krimin ndaj sistemit, do të denoncoj korrupsionin, rritjen e çmimeve dhe braktisjen e vendit. Kurrë më parë Shqipëria s'ka qenë kaq problematike, kaq e destinuar të mbahet peng nga krimi dhe korrupsioni. Kurrë më parë s'kemi qenë të friksuar nga e nesërmja. Kurrë më parë s'kemi qenë kaq të vjedhur..., e thënë më shkurt e përsëris atë që e thonë thuajse të gjithë demokratët, se ne po harrojmë çdo të thotë dinjitet dhe liri... Demokratët e Grupseksionit



tim natyrisht e duan një PD të hapur dhe demokratike me pjesë e vend për të gjithë, dhe në këtë pikë ata nuk duan të largojnë por të afrojnë demokratët në gjirin e saj. Ata nuk duan të diktojnë dhe të diktohen, se demokracia nuk është të shohësh tjetrin si armik, kur mendon ndryshe. Demokracia është liri, moral dhe përgjegjësi, jo vetëm për njërin, por për të gjithë.

BIG BOSS SERVICES
(UK) LTD
BUILDING CONTRACTORS

Instagram: [big_boss_services_uk_ltd](#)
Twitter: [@BigBossServices](#)
Facebook: [BigBossServicesUkLtd](#)

OUR SERVICES INCLUDE:

Guttering	PVC Windows	Plastering
Painting	Loft Conversion	Carpentry
Decorating	Extensions	Roofing
Power Clean	Kitchen Fitting	Brickwork
Scaffolding	Bathroom Fitting	Tiling



Tel: 020 8591 9198

Mobile: 07747 143 704 / 07883 029 474

Email: bigboss.services@yahoo.co.uk

website: www.bigboss-service.webs.com

UTR: 7168616298

CRN: 8344897

VAT NR: 215642524

Shesim apartamente në Durrës, Tiranë dhe ne zonën e plazhit deri tek Mali i Robit

Kontakt: 07883029474 dhe 00355685309800

FUQIA NUMENIKE E NARATIVIT

Një emigrant shqiptar është personazhi joshës në romanin më të ri të shkrimtares britanike, Salley Vickers. Është pikërisht „Kopshtari“ (Viking), një përrallë e një kopshti të neglizhuar anglez, që u rikthye në jetë nga një emigrant shqiptar, me emrin Murat, i cili ishte i punësuar nga dy motra, dhe që duket mjaft qartë, si një reflektim i ditëve të sotme. Romani tashmë është në një listë të gjerë vlerësimesh, pasi ai vlerësohet mjaft se autorja ka përdorur prejardhjen e saj psikologjike për të prodhuar personazhe interesante dhe me nuanca. Romani i ri nga Salley Vickers, njihet tashmë si romani i shkrimtares bestseller nga „Sunday Times“ dhe nga „Librarian“.

Thelbi i romanit

Në thelb romani është një nuance mjaft filozofike dhe psikologjike e një fabule që shkon mjaft përshtat. Në narativ artistja, Hassie Days, dhe motra e saj, Margot, blejnë një shtëpi mjaft të rrënuar në Jacobean në Hope Wenlock të Marshët Uellsian. Ndërsa Margot vazhdon jetën e saj në Londër ku ka një punë të mirë, Hassie mbetet vetëm për të punuar në kopshtin e madh, të lënë pas dore prej kohësh. Në këtë kopësht të abandonuar prej kohësh të gjata, ajo thajse është shoqëruar nga Miss Foot, që mbetet mjaft e çuditshme, me gjuhë të mprehtë. Kjo e fundit, i rekomandon asaj, Muratin, një emigrant

shqiptar, pasi mendon se është i papërshtatshëm dhe mjaft i integruar në mesin e vendasve, me qëllim për të ndihmuar Hassie në kopshtin që bëhet tashmë një integritet më vete.

Ndërsa kjo e fundit punon në kopshtin e abandonuar, që tashmë po synohet të kthehet në jetë, në shoqërinë paqësore të Muratit, Hassie mendon për jetën e saj të kaluar: rivaliteti me vëllezërit dhe motrat, ai rivalitet që dëmtoi fëmijërinë e saj dhe lidhjen e dashurisë që e la me pyetje të dhimbshme, pa përgjigje.

Por ndërsa fillon të eksplorojë historinë e shtëpisë dhe drurin misterioz aty pranë, dhimbjet e vjetra fillojnë të zbehen, pasi tashmë përjeton fuqinë shëruese të natyrës dhe zbulon botët e tjera. Në romanin e saj të ri, ku lexuesi dhe ndjesia kanë një sinonim me fjalën „përhumbës“, Salley Vickers, shkruan me depërtimin e thellë psikologjik dhe ndjenjën e fuqisë numenike të vendit që është shenja dalluese e të gjithë romaneve të saj.


Pse themi numenike?

‘Salley Vickers sheh me një sy të qartë dhe shkruan me një dorë të lehtë. Ajo është një prani që ia vlen të çmohet dhe për faktin se është një shkrimtare mjaft e mprehtë dhe me gjuhë filozofike, që më së fundi jep vërtet një natyrë të qartë të shqiptarit në gjeografi tjetër. Ajo ngjall një reagim të heshtjes. Por numenike

(numinous) është gjithashtu një „mysterium tremendum“. Numenike rrjedh si fjalë që në shekullin e 17-të nga numen latin, që do të thotë një „hyjni ose frymë që kryeson një send ose hapësirë.“ Kjo fjalë përshkruan fuqinë ose praninë dhe realizimin e një hyjnie. Nuk është etimologjikisht e palidhur me noumenon e Immanuel Kant, që është një term grek që i referohet një realiteti të panjohur që qëndron në themel të të gjitha gjërave. Fjala numenike iu dha kuptimit të saj të sotëm nga teologu dhe filozofi gjerman Rudolf Otto në librin e tij me ndikim të madh të vitit 1917 Das Heilige, i cili u shfaq në anglisht si „Ideja e të Shenjtës“ në 1923. Otto shkruan se ndërsa koncepti i “të shenjtës” përdoret shpesh për të përcjellë përsosmërinë morale - dhe e përfshin këtë - ai përmban një element tjetër të veçantë, përtej sferës etike, për të cilën ai përdor termin numinoz. Ai shpjegon numeniken si një “përvojë ose ndjenjë jo-rationale, jo-shqisore, objekti parësor dhe i menjëhershëm i së cilës është jashtë vetes”. Duke përdorur gjuhën latine, ai e përshkruan atë si një mister (latinisht: mysterium) që është njëkohësisht tmerrues (tremendum) dhe magjepsës (magjepsës).

Po kush është shkrimtarja në fjalë?

Salley Vickers lindi në



Liverpool, tek shtëpia e nënës së saj dhe u rrit si fëmijë i prindërve mjaft aktivë në Partinë Komuniste Britanike. Ajo fitoi një bursë shtetërore në Shkollën e Vajzave të Shën Palit dhe vazhdoi të jepte anglisht në Newnham College Cambridge. Ajo ka punuar, punëra të ndryshme, si pastuese, valltare, model artistesh, mësuese e fëmijëve me nevoja të veçanta, mësuese universitare e letërsisë dhe psikoanaliste. Romani i saj i parë, “Engjëlli i Miss Garnet”, u bë një bestseller ndërkombëtar. Ajo tani shkruan me orar të plotë dhe ligjëron gjerësisht për shumë lëndë, veçanërisht lidhjet midis, artit, letërsisë, psikologjisë dhe fesë. Interesat e saj kryesore janë opera, vëzhgimi i shpendëve, vallëzimi dhe poezia. Një nga poetët e preferuar të babait të saj, W.B. Yeats, ishte përgjegjëse për emrin e saj Salley, (nga gjuha irlandeze për ‘shelgun’) e cila vjen nga poezia e Yeats e muzikuar nga Benjamin Britten ‘Down by the salley gardens’ (Poshtë nga kopshti i shelgjeve).



UNË JAM KËTU ... PËR GJUHËN E BUKUR SHQIPE...

Unë jam këtu ... për Gjuhën e bukur shqipe...

Unë nuk jam këtu për politikanët. Nuk jam për veten. Nuk jam për problemet me ne. Jam këtu për Gjuhën Shqipe. Jam për të, pasi e kam parë të sakatuar në fjalime, shkrime e recit-paraqitje. E kam ndër të njësuar me hieroglifet moderne të "emoji". Dhe standardi i saj i sforcuar, anon e anon më shumë me gjuhën e rrugës ...

Unë jam këtu ... për Gjuhën e bukur shqipe...

Problemet?

Mirë ... ata janë probleme dhe gjithmonë do të mbeten. Nuk i lanë e nuk i shpëlanë, as ankesa, as ... as protesta.

Nuk i lanë as Vlora, as Saranda, as Durrësi, as Shëngjini... as të dy detet e marra së bashku, as të gjitha lumenjtë e burimet e tjera ujore.

Ata do të shtohen?

Ndoshta?! Nuk e di.

Do të kenë atë, që gjithnjë kishin, do të jenë gjithnjë me

atë që ata gjithmonë ishin ... Problemet?

Shumëkëndëshe!

Shumëdimensionëshe!

Produkte organike të nënprodukteve inorganike.

Thjesht probleme asimetrike, ... nuk mund të flas për produktin organik të tyre, as të them që një nënprodukt inorganik i dikton vetë problemet ...

Atëherë, pse do të kishte arsye që gjithnjë një dialektikë hegeliane për të filluar?

Në zgjidhje, se sa në heshtje?

Në bashkim, se sa në ndarje?

Nuk ishte Kanti, ai që hodhi apriori (tezën) dhe (antitezën) dinamizëm?

Jo?

Pastaj mendojmë se jemi analfabetë!

Duhet të jetë shkruar që të jemi të tillë!

Ndryshe, pse është kështu?

Unë nuk mund të jap tamam një mendim nga larg. Një mendim si paçavure, aq sa për „servilizëm“. Qoftë për hatër. Qoftë për ndonjë teatër. Por mund të debatoj me një

“zëdhënës të mrekullueshëm” të individit global!

Kjo do të quhej, me fjalët në tymb, Frankenshtajniane, do të sillje si të ishte urbane!

Ndoshta gjuhët ‘mish-mash’ mund ta bëjnë këtë, pa e kuptuar se bëjnë krim.

Unë pse duhet ti shqisja fjalët e mia në tymb?

Kur dëgjoj tymb, tymb fjalësh kudo?

Gjuha e bukur shqipe nuk mund ta bëjë këtë!

Nuk më lejojnë rrënjët e saj.

Nuk më lejojnë udhët e saj të pasura!

Gjuhët e tjera mund të ...

...por unë nuk mund të ...

... nuk mund dhe nuk lejoj, që vetveti të shkohet tek rritja e numrave të paragjykimeve të përlësisë gramatikore ...

Është pothuajse një turp, që intelektualët mbyllen ..., që gjuhëtarët struken..., që akademikët heshtin.

Heshtin! Heshtin dhe aty ku ndodhet është një dhomë „e zbutur“ nga kremërat, e modeluar nga shkenca. Heshtin në Akademinë e

Madhe të Shkencave, ku flenë Fjalorët e Gjuhës Shqipe?

Oh ... e drejtë ...

Kush ka kohë për ti kapur? Jo më të gjej kohë për ti hapur?! Fjala edhe për rastet ekuivalente me shkrimet dhe fjalimet qeveritare ..., tashmë është thjesht përsëritje praktike. Qeveritarë ju keni sulmuar Gramatikën Historike?!

Ju kështu na sulmoni të gjithëve ...


Nuk ka standarde të kërkuara ... me shenjën e “X”-it.

Por ka detyrime ligjore për gojën, dorën, edhe për penën e Kryeministrit!

Jo të gjithë ne duhet të kemi statusin si mësues të Gjuhës Shqipe ... disa prej nesh, kanë shkruar ndoshta më tutje?

Kjo është praktike. Kjo është logjike!

Këto fjalë nuk i lashë në tymb prej kësaj frike, por e pashë se janë vetëm të “çfilitura” nga kjo dhimbje e gjithëanshme gjenerike!



ZËRI I QARTË POETIK I POETES ARJANA FETAHU (GABA)

Autorja e vëllimit poetik „Sa do të doja...“, Arjana Fetahu (Gaba), vjen me një numër poezish të krijuara në një hapësirë kohore relativisht ndryshe, dhe në një gjeografi që kapërcen hapësirën e vendlindjen duke pikëtauar Vendin e Lirisë. Në këtë hapësirë kohore, natyrisht dhe shtrirje gjeografike poezia e saj e krijuar në vite dhe e seleksionuar natyrshëm referon njësoj sikurse narracioni „elementë“ të qartë e të mirëfilltë të poezisë, elementë në të cilët lexuesi përqendrohet për të pasuruar kuptimin e vet për një poezi, ose për një grup poezish të veçanta. Këta elementë që përfshijnë, zërin, diktimin, imazhin, figurat e të folurit, simbolikën dhe alegorinë, sintaksën, tingullin, ritmin dhe metrin, po ashtu edhe strukturën, janë thuajse një tërësi e kompletuar në këtë vëllim të saj.

Ndërsa i ndajmë këto elemente kuptojmë se tërësia e tyre është komplekse, madje ndajmë se ata gjithmonë veprojnë njëkohësisht dhe na shfaqen në lidhjen e tyre narrative si në një histori. Nuk është e vështirë, për shembull, të diskutosh për zërin që ndjen nga thellësia e poezive, po aq nga zëri që të ngjiz teksta i lexon, sepse menjëherë pas leximit të poezive ke krijuar imazhe, ke prekur zë, ke ndërë metër, ke fiksuar diktim dhe ke kuptuar thellësisht sintaksën. Mbi të gjitha, këta elementë zbulojnë plotësisht atë që autorja e shtjellon në lidhje me „temën“ e poezisë së saj, kuptimin, ose funksionin e saj. Për shembull, tek poezia „Ti më lëndon se të dua unë...“ nuk është e vështirë të krijosh të gjithë këto tipare me një lexim të thjeshtë e të ndjesh njëloj kuptimin e vargut „e mua më lagte i njëjti shi i mallit“.

Sikurse kuptohet këtu

është një zë, zëri i qartë i poetes, që i referohet qëndrimit të nënkuptuar të saj ndaj subjektit të marë në konsideratë. Në anën tjetër diktohet dhe një ton fiksativ gjatë një leximi të thjeshtë, ku kuptohet se ai është një abstraksion, që ne e bëjmë duke lexuar nga detajet e gjuhës së kësaj poezie. Në këtë poezi natyrshëm më pas ndjehet përdorimi i metrit dhe rimës; përfshirja e llojeve të caktuara të detajeve dhe përjashtimi i llojeve të tjera; zgjedhje të veçanta të fjalëve dhe modelit të fjalisë, të imazhit dhe të gjuhës figurative. Kjo poezi është e aftë dhe mund të përcjellë nderim ndaj temës së saj, knuk afron cinizëm, nuk është mes frikës, larg neverisë, po ashtu nuk ka keqardhje, zhgënjim, por ka pasion, pa shfaqur monotoni. Toni i kësaj poezie gjatë leximit na ofron me atë që ka të bëjë shumë me kuptimin, apo me thelbin që i referohet zgjedhjes së fjalës dhe lidhet ngushtë me imazhet dhe figurat e fjalës.

Autorja zgjedh një fjalë për të arritur një efekt të caktuar ndijor, emocional ose intelektual. „Ora në mur dhimbjen po ma nje“ shprehet autorja tek poezia „Ah, mor Zot!“ Zgjedhja e fjalës „dhimbjen“, për shembull, sugjeron diçka të ndryshme nga, të themi, „vuajtur“, „trazuar“, „ndjerë“, „përhumbur“, etj., Sepse ajo fjalë e zgjedhur, pra „dhimbjen“ njësoj sikur secila fjalë e përafërt me të, sugjeron një qëndrim, imazh, ose edhe disa qasje të ndryshme, tek të cilat imazhi konsiderohet, perceptohet dhe mbetet si një imazh në memorie. Autorja me këtë përzgjedhje seleksionon për të krijuar mundësitë, dhe kjo gjithmonë duke zgjeruar kuptimin dhe duke e lidhur atë me fjalë dhe imazhe të tjera. Për shembull, vendosja e fjalëve në kontekste të reja tek disa poezi të tjera

krijon metafora, sepse fjala e saj poetike e përzgjedhur sugjeron një kuptim, dhe konteksti një tjetër kuptim. Tek poezia „Amanet“ autorja shkruan se „Ti vdekjen s'mund ta gënjesh“. Pra, qartësia është sa me nëntekstin e fjalës që sugjeron një kuptim të qartë, po aq dhe me kontekstin që jep një arsyetim tjetër të kuptimit të vetë. Por kjo është jo thjesht si e tillë, sepse në pikën e dukshme dhe të duhur që shihet qartë ajo vetvetiu percepton dhe lind e krijon imazhe.

Siç u përmend më herët, zgjedhja e fjalëve krijon imazhe, përfaqësimin konkret të një përshtypjeje, ndjenje, ose ideje. Imazhet prekin shikimin, dëgjimin, ndjenjën e nuhatjes dhe shijes dhe perceptimet prekëse. Imazhi i këtyre poezive referohet një modeli të detajeve të lidhura. Nuk mund të qëndrosh larg nga imazhet që të krijon poezia „Vera dhe dashuria“, pasi nënkupton me njëherë se „Në qoshen ku e zë gjithmonë,/Përballë kur më kaplon vetmia,/Një gotë e dashur vere qëndron,/Qan dhe ajo hallet e mia.“

Natyrisht, kur imazhet formojnë modele të detajeve të ndërlidhura që përcjellin një ide, ose ndjenjë përtej asaj që imazhet përshkruajnë fjalë për fjalë, ne i quajmë metaforikë,


ose simbolikë dhe këtë e bën mjaft mirë autorja e poezive të tilla si, „Grua“; „Hapuj botë se plasa“; „Hënë“; „Ikja jote s'është burgu im!“; „Janë e ardhmja, janë vetë jeta“; „Katër ditët e dimrit tënd“; „Ku i kam miqtë?!“; „Karajfil të lëshon buza“; „Kulaçi“; „Lamtumirë“ etj.

Tek këto poezi detajet sugjerojnë një gjë të ndjeshme, për sa i përket një tjetre, po aq të rëndësishme, sikurse është tek Kulaçi“ ku nëna është një simbolikë më vete „E dinim që me të s'do na shuhej uria,/Dhe stomaku do mbetej prapë bosh,/Por në duart e nënës rri vetë dashuria,/Dhe ato ke dëshirë ti vështrosh.“ Për shembull, tek poezia „Maji u ngrys në qënien time“ imazhet e dritës shpesh përcjellin njohuri dhe jetë, ndërsa imazhet e errësirës sugjerojnë injorancë ose vdekje: „Maji u ngrys në qënien time nga një re,/që diellin zu peng,/e papritmas u shua një dritë.“ Ky kërcim nga një imazh në homologun e tij simbolik bazohet në një akt interpretues dhe duhet të bëhet në kontekst. Për shembull, e bardha zakonisht shoqërohet me pastërtinë, pastërtinë dhe virgjërinë, dhe sugjeron të keqen absolute, kur përdorimi i asaj ngjyre simbolike është konsistente brenda vargut.



KONKURRON ME TË GJITHA

“Hilal Food Centre” vazhdon të mbetet lideri i tregut ushqimor për shqiptarët e Londrës. Nuk është ndonjë sekret që tani themi tashmë hapur se pronari i këtij supermarketi, z. Mahmud gjithnjë e më shumë i kushton vëmendjen e tij të përditshme cilësisë, kualitetit, efektit dhe efektivitetit të produktit që shkon në duart e klientit. Ai dhe stafi i tij i drejtuar në mjaft raste nga Mehmeti, kanë një strategji të komunikimit dhe një efikasitet të arritjes që e përditshmja të mbetet një racionalitet i domosdoshëm i vlerës dhe cilësisë. Prandaj produktet e këtij supermarketi janë gjithnjë më të kërkuarit dhe më të konkruarit në tregun londinez e më gjerë. Cilësia është parimi kryesor dhe çmimet natyrshëm janë modeli që ata synojnë të mbajnë gjithnjë në dobi të klientëve. Vlerë e mirë, 54.1 përqind; orë të përshtatshme tregtare, 52.6 për qind; dhe ushqime të përgatitura në mënyrë higjienike 52.2 përqind; gjithashtu e paraqitur në mesin e pesë cilësive që blerësit e ushqimeve vlerësojnë më shumë në një supermarket të tillë sikurse është “Hilal Food Centre”.



Gama e zgjedhjes

Supermarketi “Hilal Food Centre” shet një sërë produktesh. Konsumatorët kanë një larmi të madhe zgjedhjesh për të zgjedhur produktin që duan. Është e rëndësishme që “Hilal Food Centre” mban të gjitha produktet në hapësirën e tij të madhe, sepse e di që përndryshe konsumatorët

do të zhvendosen në supermarkete të tjerë, ose shitës me pakicë. Konsumatorët e “Hilal Food Centre” janë shumë të ndjeshëm në atë që blejnë. Ata gjithmonë pëlqejnë që supermarketi “Hilal Food Centre” që blejnë duhet t'i mbajë produktet gjatë gjithë kohës. Supermarketi “Hilal Food Centre” gjithmonë monitoron trendin e blerjes së konsumatorit dhe gjithmonë mban produkte të caktuara në magazinë gjatë gjithë kohës.

Produktet janë në rafte

Produktet e “Hilal Food Centre” janë në rafte. Të gjitha produktet shfaqen siç duhet dhe përzierja e produktit mbetet e përshtatshme në mënyrë që të bëhet e lehtë për konsumatorët të zgjedhin produktet. Supermarketi “Hilal Food Centre” monitoron atë që blen më shumë konsumatori me

produktin e veçantë ose atë që ai/ajo do të donte të blinte me atë produkt dhe më pas ata i shfaqin ato produkte në dyqan pranë njëri-tjetrit. Është e lehtë për konsumatorët që të zgjedhin produktet me lehtësi. Është parë gjithashtu se “Hilal Food Centre” shfaq gjithmonë produkte të nevojës bazë si Qumështi, Buka etj në cepin e fundit të dyqanit kështu që konsumatorët duhet të arrijnë atje duke kaluar dhe shikuar të gjitha produktet e tjera të cilat i tërheqin dhe binden për të blerë.

Strategjia e Çmimeve

Çmimi është faktori kryesor i cili ndikon tek konsumatorët e “Hilal Food Centre”. Supermarketet konkurrojnë me njëri-tjetrin për të shitur produktet me çmimin më të mirë për konsumatorët. Disa duket se janë konkurrentët më të mëdhenj në gamën e konsumatorëve ekonomikë, por nuk mundën me “Hilal Food Centre”.



DAILY FRESH HALAL MEAT AND FRUIT



HILAL FOOD CENTRE

International Food Centre

318-324 Kilburn High Road,
London, NW6 2QN
020 7372 1059

VEAL
SPECIAL
OFFER

